

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË

KONTRATË KONCESIONI

HIDROCENTRALI POÇEM

KONCESIONARI

Subjekti per Qëllime të Veçanta, shoqëria “KOVLU ENERGJI” sh.p.k.

Kontrata e Koncesionit, e formës “BOT” (Ndërtim - Operim - Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit

Përmbajtje

Hyrje.....	6
KREU I.....	7
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	7
NENI 1 - PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME.....	7
1.1. Konçensionari.....	7
1.2. Përkufizime	7
NENI 2 - OBJEKTI I KONCENSIONIT.....	21
NENI 3 - KARAKTERISTIKAT E HIDROCENTRALIT	21
3.1. Hidrocentrali Poçem.....	22
3.2. Kushtet hidroteknike dhe te tjera qe duhen respektuar	22
NENI 4 - PERIUDHA E KONCESIONIT.....	24
4.1. Periudha e koncesionit.....	24
4.2. Rastet e zgjatjes së Periudhës së Koncesionit:	24
KREU II.....	25
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES	25
NENI 5 - TË DREJTAT E KONCESIONIT.....	25
5.1 Sipërmarrja e Përgjithshme	25
5.2 Dhënia e të drejtave të Koncesionit.....	25
5.3 Dhënia e pozicionit gjeografik të Shesheve	26
5.4 Marrëveshjet dhe Përfaqësimet nga Autoriteti Kontraktues.....	26
5.5 Objektet e transmetimit	29
5.6 Krijimi i zonave të sigurisë	29
5.7 Ujërat e mbetura/ ujitja.....	29
NENI 6 - FAZAVE PARA- NDËRTIMORE	30
6.1. Njësia e Zbatimit të Projektit (NJZP).....	30
6.2. Dispozita të Përgjithshme.....	30
6.3. Mbyllja Financiare	33
6.4. Faza para-ndërtimore nën përgjegjësinë e konçesionarit	33
6.5. Kontratë të fazës para- ndërtimore nën përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues	34

6.6.	Rritja e shpenzimeve	35
6.7.	Fillimi i fazës ndërtimore	35
NENI 7 - TARIFAT, RAPORTIMI & AUDITIMI		35
7.1.	Tarifa e koncesionit, llogaritja dhe pagesa e taksës së koncesionit.....	35
7.2.	Raportimi Financiar dhe Auditimi	36
NENI 8 - KONCESIONARI DHE INVESTIMET MINIMALE TË KAPITALIT		36
8.1.	Investimet minimale të kapitalit	36
8.2.	Roli i Konçesionarit.....	36
NENI 9 - MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E PËRGJITHSHME		36
9.1.	Monitorimi	36
9.2.	Mbikëqyrja e përgjithshme e punimeve	37
NENI 10 - DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES		37
KREU III		38
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT		38
NENI 11 - DETYRIMET E KONCESIONARIT		38
11.1.	Përgjegjësia e Konçesionarit	38
11.2.	Referenca të tjera.....	38
11.3.	Shërbimet	38
11.4.	Garancitë	38
11.5.	Zbatimi i Projektit dhe Objekti Kontratës	38
11.6.	Veçanërisht Konçesionari duhet që:.....	39
NENI 12 - NDËRTIMI I IMPIANTIT		41
12.1.	Projektimi	41
12.2.	Ndërtimi	41
12.3.	Rrethana të veçanta gjatë fazës së ndërtimit: Zgjatja e afatit të përfundimit të punimeve ..	42
NENI 13 - VLERËSIMI I INVESTIMEVE.....		44
NENI 14 - PROGRAMI I PUNIMEVE.....		44
NENI 15 - TESTIMI I VEPRËS		45
15.1.	Testi i vënies në punë (performancës).....	45
15.2.	Raportimi përfundimtar dhe Certifikata përfundimtare	45
15.3.	Lëshimi i njoftimit të Mos përmbushjes.....	45
15.4.	Detyrimet pas përfundimit.....	46

15.5.	Braktisja	46
NENI 16 - FUNKSIONIMI DHE MIRËMBAJTJA		47
16.1.	Vënia në punë.....	47
16.2.	Raportimi.....	48
NENI 17 - ZGJIDHJA E KONTRATËS SË KONCESIONIT		48
17.1.	Zgjidhja e parakohshme e Kontratës.	48
17.2.	Mos përmbushjet nga Konçesionari.	49
17.3.	Mos përmbushje nga Autoriteti Kontraktues	50
17.4.	Forca Madhore e Tejzgjatur.	51
17.5.	Njoftimet me shkrim të kryera nga Autoriteti Kontraktues, apo Konçesionari.....	51
17.6.	Detyrimet ne rast zgjidhje te Kontratës Koncesionare	52
17.7.	Zgjidhja e kontratës nga secila palë	53
17.8.	Njoftimi i zgjidhjes së kontratës.....	53
17.9.	Zgjidhja e kontratës me konsensus.....	53
17.10.	Të drejtat e Palëve Financuese dhe zëvendësimi i Konçesionarit.....	53
NENI 18 - KONTRATAT ME PALËT E TRETA		54
NENI 19 - SIGURIMI I KONTRATËS.....		55
NENI 20 - SIGURIMET		55
NENI 21 - VLERA E RI - INVESTIMIT		56
NENI 22 - KUFIZIMET		56
NENI 23 - FORCA MADHORE DHE VEPRIMI SHTETËROR THELBËSISHT NË KUNDËRSHTIM ME KONTRATËN		57
23.1.	Forca Madhore	57
23.2.	Veprimi Shtetëror në kundërshtim me Kontratën	57
NENI 24 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE LIGJI I APLIKUESHËM		58
24.1.	Zgjidhje miqësore	58
24.2.	Eksperti teknik dhe ekonomik	58
24.3.	Arbitrazhi	60
24.4.	Ligji i Aplikueshëm	61
NENI 25 - SANKSIONET		61
NENI 26 - RREGULLIMI I SHKELJEVE.....		63
NENI 27 - TRANSFERIMI I ASETEVE DHE PERIUDHA KALIMTARE.....		63



NENI 28 - MBARIMI I KONTRATES	64
NENI 29 - KONFIDENCIALITETI	64
NENI 30 - NDRYSHIME	65
NENI 31 - TE NDRYSHME.....	65
ANEKSI A – FORMULARI I OFERTES DHE OFERTEN TEKNIKE	69
ANEKSI B – PREVENTIVI I VOLUMEVE DHE KOSTO E NDERTIMIT TE HEC POCEM	70
ANEKSI C – GRAFIKU I ZBATIMIT TE PUNIMEVE.....	71
ANEKSI D - FORMULARI I NJOFTIMIT TË MBYLLJES FINANCIARE	72



REPUBLIKA E SHQIPERISË

ZYRA E NOTERISË

NR. 2144 / Rep.

NR. 755 / Kol.



KONTRATË E KONCESIONIT E FORMËS “BOT” (NDËRTIM - OPERIM - TRANSFERIM) PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “POÇEM”



Në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, më datë 05, muaji Shkurt, viti 2016 (dy mije gjashtëmbëdhjetë), para meje noter Ilir Bejtja, anëtar i dhomës së Noterisë Ilir Bejtja me adresë Sanj Parku, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, që më poshtë do të quhet “AUTORITET KONTRAKTUES”, përfaqësuar me autorizimin nr. 2632/39 Prot. datë 1.7.2016 nga Zëvendësministri, Z. Ilir Bejtja,

DHE

Subjekti për Qëllime të Veçanta, shoqëria “KOVLU ENERGI” sh.p.k., e krijuar nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive e se drejtës turke, “Çinar-San Hafriyat Nakliyat İnşaat Turizm San Ve Tic Ltd.Şti” dhe “Ayen Enerji Anonim Şirketi”, që më poshtë do të quhet “KONCESIONARI” e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKR me NIPT L62010004L date 10.8.2016 regjistrimi, me seli Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga Sami Frashëri, pranë Qendrës Nobis, Kulla F, Kati i 2-te, Tirane, Shqipëri, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. Yüksel Çinar, :

Hyrje

Duke patur parasysh se:

Qeveria e Republikës së Shqipërisë:

1. I ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj me anë të procedurave të konçesionit, për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të Sistemit energjetik kombëtar;
2. Konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë.
3. Vlerëson formën “BOT” të konçesionit, si një formë e konçesionit që bën të mundur nxitjen e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj me anën e kapitalit privat;
4. Është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;
5. Mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike;
6. Autoriteti Kontraktues, në bazë të ligjit nr. 125/2013 “Për Konçensionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar, VKM nr. 576 datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e konçensioneve për hidrocentralet”, dhe të shtojcave nr. 9 “Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit” dhe shtojca nr. 10 “Kriteret e Vlerësimit”, dhe Urdhrit të Ministrit nr. 288, datë 24.11.2015 (MEI) “Për ngritjen e komisionit për dhënien me konçesion të hidrocentralit “Poçem”, i ndryshuar me urdhrin nr. 288/1, datë 22.01.2016, ka vijuar me hedhjen në sistemin e prokurimit elektronik, procedura e konçesionit pranë APP me datë 24.01.2016 me nr. Ref - 22092 - 01 - 24 - 2016.

Konçensionari:

1. Ka kryer studimin tekniko - ekonomik dhe mjedisor, për ndërtimin dhe operimin e hidrocentralit të Poçemit, si një propozim i pakërkuar, dhe në përfundim të procedurës përzgjedhëse konkurruese është vlerësuar si ofertuesi më i mirë.

2. Është i interesuar për të investuar në ndërtimin e Hidrocentralit të Poçemit në lumin Vjosa me qëllim prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të zonës;
3. Zotëron ose do të zotërojë në kohën e duhur kapacitetet e nevojshme tekniko - financiarë, për të realizuar Projektin e miratuar sipas Objektivit të kësaj Kontrate;
4. Zotëron ose do të zotërojë në kohën e duhur aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standartet ndërkombëtare;
5. Oferta e paraqitur nga Konçensionari është vlerësuar si “fituese” nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 29.04.2016

Për sa u përket me sipër, Palët e sipërpërmendura bien dakord për sa më poshtë:



KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1 - PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1. Konçensionari

Konçensionari i kësaj kontrate është Subjekti për Qëllime të Veçanta, shoqëria “KOVLU ENERGJI” sh.p.k. e së drejtës shqiptare, i formuar nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive, “Çinar-San Hafriyat Nakliyat İnşaat Turizm San Ve Tic Ltd.Şti” dhe “Ayen Enerji Anonim Şirketi” sipas Kontratës e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive nr. 18090 date 18.12.2015:

1.2. Përkufizime

Kurdoherë që përdoren në këtë marrëveshje (duke përfshirë edhe Anekset e saj), përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtme do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

Autoriteti Kontraktues: Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI)

Përfaqësues i Autoritetit Kontraktues është çdo person, fizik apo juridik, i caktuar nga Autoriteti Kontraktues për ta përfaqësuar atë në lidhje me zbatimin e dispozitave të kësaj Kontrate (duke përfshirë por jo kufizuar edhe për sa i përket testeve të vënies në punë dhe pranimin e punimeve të ndërtimit), me kusht që Autoriteti Kontraktues të njoftojë menjëherë konçensionarin rreth përfundimit ose zëvendësimit të tij

Subjekti për Qëllime të Veçanta është shoqëria e re koncesionare e krijuar nga Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive turke “Çınar-San Hafriyat Nakliyat İnşaat Turizm Sanayi ve Ticaret Limited Şirketi” dhe “Ayen Enerji Anonim Şirketi”, të cilët janë shpallur fitues të procedurës konkurruese për konçensionin e hidrocentralit Poçem, mbi lumin Vjosa.

Ligji “Per koncesionet”: Ligji nr.125/2013 “Per Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” i ndryshuar. Çështjet e kontratës që nuk rregullohen me këtë ligj, janë subjekt i dispozitave të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994. “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

Ndryshim në Ligj është:

- a) Miratimi, shpallja, hyrja në fuqi e çdo ligji të ri, kërkesë ligjore apo akti tjetër detyrues apo shfuqizimi, ndryshimin, ri-interpretimi, ndryshimi në zbatim apo modifikimi, i ndonjë ligji ekzistues apo kërkesë ligjore në Shqipëri, pas datës së hyrjes në fuqi të Kontratës për Projektin që:
 - i. I drejtohet drejtpërdrejt Projektit dhe është diskriminues ose shkakton diskriminim ndaj konçensionarit; ose
 - ii. Parashtron masa apo kufizime diskriminuese për kontrollin e çmimeve të shitjes apo parashikon kufizime të shitjeve që prekin konçensionarin të energjisë në Shqipëri, përveç rasteve kur ndaj tij vendoset një detyrim i shërbimit publik në përputhje me ligjin 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
- b) Anulimi, heqja, ndryshimi, shtimi apo zëvendësimi, duke keqësuar pozitën e konçensionarit, i një Autorizimi/leje/liçensë që i jepet Konçensionarit dhe është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të kësaj Kontrate ose të ndonjë kontrate tjetër të nevojshme për operimin, mirëmbajtjen ose financimin e projektit, përveçse kur:
 - i. Anulimi, heqja, ndryshimi, shtimi ose zëvendësimi i këtij Autorizimi të tillë kryhet në përputhje me kushtet e parashikuara në legjislacionin në fuqi; ose
 - ii. Konçensionari nuk përmbush kushtet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për marrjen e këtij Autorizimi apo kushtet e parashikuara në të, dhe
- c) Refuzimi për dhënien e një Autorizimi/leje/liçensë, për të cilën Konçensionari ka aplikuar rregullisht, përveç rasteve kur refuzimi e organit shtetëror që lëshon këtë Autorizim/leje/liçensë:
 - i. Është bërë në përputhje me ligjin apo kriteret ligjore që rregullojnë dhënien e Autorizimit/lejes/liçensës, apo refuzimi është për shkak të vendosjes së ndonjë kushti të arsyeshëm nëse ligji e parashikon një mundësi të tillë; ose

- ii. Mund të ishte shmangur nga vetë Konçensionari duke vepruar si një Operator i Arsyeshëm dhe i Kujdesshëm.

Përfundim Paraprak do të thotë përfundimi i fazës së Ndërtimit dhe fillimi i Fazës së Operimit, pas marrjes së Certifikatës Përfundimtare, të hidrocentralit, në përputhje me këtë Kontratë.

Kontrata e Konçensionit është kjo kontratë, anekset dhe çdo dokument tjetër që bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.

Objekti i kësaj kontrate është financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentralit dhe transferimi i tij nga Konçensionari tek Autoriteti Kontraktues.

Investimi është vlera monetare totale e ndërtimit dhe pajisjes së hidrocentralit me makineritë e nevojshme, deri në datën e Përfundimit të Punimeve.

Fillimi i Punimeve, data e fillimit të zbatimit të projektit, brenda 30 ditëve nga miratimi i tij sipas kësaj kontrate.

Vënia në Punë e Hidrocentralit është fillimi i prodhimit të energjisë elektrike pas testimit, sipas kësaj kontrate.

Kontratat janë të gjitha kontratat e nënshkruara nga Konçensionari, me sipërmarrës për realizimin e punimeve ose çdo kontratë tjetër e lidhur me të tretët që ka si objekt apo shërben si mjet për të bërë të mundur operimin e hidrocentralit dhe/ose sigurimin e fondeve financiare.

Leje, Liçensa, Autorizime janë akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatës publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Operimi përfshin të gjitha veprimet e konçensionarit për prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e Energjisë Elektrike.

Tarifa Konçensionare është kompensimi monetar që paguan koncesionari për koncesionin në shumen dhe mënyrën e përcaktuar në nenin 7

Subjekti i Furnizimit me Energji Elektrike përfshin çdo person juridik të liçensuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit shqiptar.

Sigurimi i Kontratës është vlera e siguruar në një shoqëri sigurimesh, me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e mos përmbushjes nga konçensionari të detyrimeve të parashikuara në kontratë.

Sigurimi i Operimit është vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme bankare ose në një shoqëri sigurimesh, me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kontratës nga Konçensionari, gjatë fazës së operimit të Projektit.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror që vepron në përputhje me Ligjin nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjin për sektorin e gazit natyror.

Aneks është çdo shtojcë, deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga palët që i bashkëlidhet kësaj Kontrate, si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj, tani apo në të ardhmen.

Pala Financiare është çdo institucion financiar i licencuar si i tillë, që përfshin Huadhënësin ose Palën Financuese, që ndihmon Konçensionarin në financimin e Projektit.

E Drejta për Kalim është e drejta për të kaluar mbi dhe nën shesh, dhe në çdo pjesë të tij, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të me qëllimin e zbatimit të kësaj kontrate, pa ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë.

Gëzim i Qetë do të thotë e drejta ekskluzive për të përdorur dhe gëzuar Sheshin (duke përfshirë Objektivin Ekzistues) dhe të Drejtën për Kalim gjatë Periudhës së Konçensionit, në përputhje me këtë Kontratë, pa ndërhyrje të pajustificuara nga Autoriteti Kontraktues ose nga ndonjë subjekt shtetëror.

Kostot Aktuale të Investimeve përfshijnë kostot totale të investimeve të kryera nga Konçensionari për zbatimin e projektit deri në Datën e Përfundimit të Punimeve.

Data e Përfundimit të Punimeve është data në të cilën lëshohet Certifikata Përfundimtare, ose konsiderohet të jetë lëshuar, pas përfundimit të ndërtimit Hidrocentralit.

Palë e Dëmtuar është pala që ka pësuar një dëm (ose që pretendon të jetë dëmtuar) nga Forca Madhore ose nga shkaqe të tjera gjatë zbatimit të kësaj kontrate.

Filial përfshin çdo person juridik, i cili është direkt ose indirekt, përmes 1 ose më shumë ndërmjetësve, i kontrolluar nga një person juridik tjetër, shoqëri tregtare bijë që kontrollohet nga një shoqëri tjetër mëmë, sipas ligjit për shoqëritë tregtare; degë, zyrë përfaqësimi apo agjenci e një shoqërie tregtare.

Kosto Totale e Investimeve është secila dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet e paguara ose të pagueshme gjatë çdo periudhe deri dhe duke përfshirë datën aktuale të përfundimit të Punimeve nga ose në emër të Konçensionarit në lidhje me Projektin, duke përfshirë, por pa u kufizuar, shpenzimet e të gjithë planifikimeve, zhvillimeve, eksplorimeve, ndërtimeve, punimeve dhe mirëmbajtjes (si në veçanti, por pa kufizim, pagesa për personelin dhe menaxhimin, punimet civile, vepra hidro-mekanike, pajisje mekanike dhe elektrike, infrastruktura, blerjen e tokës, risistemimin e njerëzve, kompensimin e pronës, studime, studime fizibiliteti, projekte, mbikëqyrje dhe administrim, akses në lidhje me rrjetin elektrik dhe përdorimit të tij, etj), pagesa për leasing, të mundshme, sigurimet, tatimet (të tilla si, por pa kufizim, pagesat e tatimit mbi të ardhurat, taksa konçensionari, taksa urbane dhe infrastrukture, etj. nëse ato janë të aplikueshme)

kostot dhe tarifat që kanë lidhje me pajisjen dhe mbajtjen në funksionim, lejet dhe liçensat, pagesat sipas Kontratës së Konçensionit ndaj Autoritetit Kontraktues ose ndaj çdo organi tjetër shtetëror, ligjore, kontabiliteti dhe tarifat e tjera profesionale që kanë lidhje me ndonjë nga pikat e mësipërme, dhe kostot e financimit të borxhit dhe të kapitalit, përveç kapitalit të shlyer nga një Ortak ose një person i lidhur me një Ortak, si dhe instrumente financimi të ngjashme në lidhje me shpenzimet dhe kostot e sipërpërmendura (të tilla si, në veçanti por pa kufizim, të gjitha interesat për Hua të marra nga Konçensionari dhe të gjitha pagesat e bëra në lidhje me këto hua dhe garancitë e dhëna për to).

Kontratë do të thotë Kontratë Konçensionit (dhe të gjitha Anekset, të cilat janë pjesë integrale e saj).

Autorizim është çdo pëlqim, leje, liçensë, miratim, certifikatë apo akt i një organi shtetëror, lëshimi apo rinovimi i të cilit është përgjegjësi e organeve shtetërore, i nevojshëm për ekzekutimin e kësaj Kontrate, zbatimin e projektit, ndërtimin dhe funksionimin e impianteve, shitjen e prodhimit dhe nxjerrjen jashtë të fitimeve nga ky aktivitet, ose pagimin e ndonjë detyrimi për shërbimet përfshirë, por pa u kufizuar në to, të gjitha lejet në lidhje me:

- a. Sheshet dhe gëzimin e qetë të tyre;
- b. Mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe miratimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis nga Ministria e Mjedisit të Republikës së Shqipërisë;
- c. Të drejtat e përdorimit të ujit;
- d. Të drejtat (duke përfshirë edhe përdorimin e guroreve) për përdorimin e lëndëve të nevojshme të ndërtimit, të cilat gjenden në Republikën e Shqipërisë, janë apo jo të pranishëm në Shesh (përfshirë këtu dhe materialet nga lumi i Vjosës);
- e. Të drejtat për të prerë dhe përdorur lëndë drusore nga pyjet në Shesh;
- f. Të drejtën për tu lidhur me rrjetin elektrik

Oferta ka kuptimin e përcaktuar në pjesën hyrëse të kësaj Kontrate.

Ditë Pune janë të gjitha ditët e javës, përjashtuar ditët e Shtunë, e Diel dhe të gjitha ditët e pushimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë.

Muaj janë të gjithë muajt e vitit të përlogaritura me bazë kalendarike.

Afatet në këtë kontratë janë të gjitha me bazë kalendarike.

Mekanizmi i Zhvillimit të Pastër (MPZH) është mekanizmi i përcaktuar në nenin 12 të Protokollit të Kiotos.

Protokolli i Kiotos: Protokolli i Konventës së Kombeve të Bashkuara, për ndryshimet klimatike, i cili ka vendosur objektiva të detyrueshëm për reduktimin e shkarkimit të gazeve, me efekt serre, për vendet e zhvilluara. Vendi ynë edhe pse nuk ka detyrime për reduktimin e gazeve, me

efekt serre, mund te marre pjese ne mekanizmin per zhvillim te paste (MZHP) dhe te jete përfitues projektesh nga vendet e zhvilluara.

Raporti Përfundimtar është raporti i përfundimit të punimeve që lëshohet nga Konçensionari, në përfundim të Punimeve të ndërtimit të një impianti.

Të Dhëna Teknike të Projektit janë specifikimet teknike për impiantet të përgatitura nga ana e Konçensionarit, siç përshkruhet në mënyrë të shkurtuar në Aneksin A.

Të Drejta Konçensionare janë të drejtat e konçensionarit që nga hyrja në fuqi e kontratës.

Paaftësia Paguese e Konçensionarit ndodh nëse verifikohet një nga rastet e parashikuara më poshtë, në lidhje me Shoqërinë Konçensionare:

- a. Miratimi i një vendimi nga aksionarët për mbylljen e Shoqërisë së projektit, me përjashtim të rasteve të ristrukturimit të saj;
- b. Dorëzimin nga Shoqëria e Projektit të një kërkesë vullnetare falimentimi, moratoriumi ose kërkesa të tjera të ngjashme;
- c. Caktimi i një likuidatori në një procedurë për mbylljen e Shoqërisë së Projektit, nëse ky emërtim nuk anulohet apo pezullohet brenda 3 muajve nga dita e caktimit; ose
- d. Marrja e një Vendimi nga ana e një Gjykate kompetente, për mbylljen e Shoqërisë së Projektit, nëse ky vendim nuk pezullohet apo shfuqizohet brenda 3 muajve.

Pika e Lidhjes është çdo pikë ku linjat e transmetimit ose te shpërndarjes se energjisë elektrike te ndërtuara nga konçensionari janë te lidhura me rrjetin elektrik kombëtar.

Fitim i Munguar është çdo humbje ose dëmtim i pësuar nga Pala i cili nuk është humbje e drejtpërdrejt përveçse humbje apo dëmtim në lidhje me:

- a. Dëmet e likujdueshme; dhe
- b. Shpenzimet nga polica sigurimi të detyrueshme për tu lidhur sipas kësaj kontrate.

Ndërtimi përfshin njohjen dhe investigimin me situatën, projektimin, pajisjen, sigurimin e mjeteve dhe materialeve, ndërtimin, rehabilitimin dhe rinovimin, instalimin, testimin, nën kontraktimin e të tretëve dhe çdo veprim tjetër i mëvonshëm për zbatimin e punimeve në përputhje me kërkesat e kësaj Kontrate dhe lejet e siguruara.

Duke ndërtuar dhe i ndërtuar interpretohen gjithashtu në përputhje me këtë kuptim. Termi “**ndërtim**” përfshin por nuk kufizon të gjitha punimet civile, instalimet elektro-mekanike, turbinat, gjeneratorët, centralet elektrike, pajisjet ndihmëse, transformatorët dhe linjat e transmetimit.

“Leje ndërtimi” është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe i lejimit të punimeve përkatëse.

“Leje zhvillimi” është akti i përcaktimit të kushteve zhvillimore për një parcelë/pronë të caktuar, që shërben si bazë për pajisjen me leje ndërtimi.

Faza e Ndërtimit është periudha nga Data e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit deri ditën e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit.

Data e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit është data në të cilën Konçensionari fillon punimet e ndërtimit.

Data e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit është data pas 36 muajve nga data e fillimit të punimeve të ndërtimit.

Kontroll i përdorur si emër ose si folje nënkupton pushtetin për të zgjedhur një shumicë në bordin e drejtorëve (apo ndonjë tjetër organ i ngjashëm) ose drejtimin dhe menaxhimin e politikave të një subjekti, në mënyrë direkte ose indirekte, qoftë nëpërmjet posedimit të kuotave të pronësisë, sipas kontratave të përcaktuara ose në forma të tjera.

Ulja e Kapacitetit të Instaluar ka kuptimin e dhënë në nenin 11, por subjekt i nenit 3.

Projekt i Zbatimit është projektimi i propozuar në lidhje me çdo impiant, i cili i dorëzohet Autoritetit Kontraktues së bashku me kërkesën për miratim dhe me miratimin nga Autoriteti Kontraktues, do të jete pjese përbërë e Kontratës së Koncesionit

Humbje Direkte do të thotë:

a. Për Konçensionarin

- i. Çdo humbje e të ardhurave (vlerat e humbura si rezultat i shkeljes ose mos përmbushjes së detyrimeve të kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktues ose nga një Veprim Shtetëror Thelësisht në Kundërshtim me Kontratën (VShThKK), minus vlerat e kursyera si rezultat i shkeljes ose mos përmbushjes së detyrimeve të kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktues ose nga VShThKK, me kusht që normat e skontimit dhe parimet Standarte të tregut të zbatohen në lidhje me të ardhurat e më pasme) dhe/ose çdo kosto shtesë e shkaktuar si rezultat i shkeljes ose mos përmbushjes së detyrimeve të kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktues ose nga VShThKK në kundërshtim me Kontratën; dhe
- ii. Çdo humbje apo dëm i pësuar nga Konçensionari si rezultat i dëmtimeve të pronës apo dëmtimeve personale.

b. Për Autoritetin Kontraktues

- i. Çdo humbje neto të Tarifës së Konçensionit, (Tarifa e Konçensionit humbur si rezultat i një shkeljeje ose mos përmbushjeje të detyrimeve të kësaj kontrate, me kusht që normat e skontimit dhe parimet standarde të tregut të zbatohen në lidhje me pagesat e mëvonshme të Tarifës së Konçensionit) dhe/ose

- ii. Çdo humbje ose dëm i pësuar nga Autoriteti Kontraktues si rezultat mos përbushjes së detyrimeve kontraktore nga ana e Konçesionarit; she/ose
- iii. Çdo humbje ose dëm i pësuar si rezultat i dëmtimit të pronës apo dëmtimeve personale.

Energjia elektrike është energjia elektrike e prodhuar, që rrjedh apo furnizohet në një qark elektrik gjatë një intervali të dhënë kohor, i matur në njësitë kilovatore (kWh).

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis është raporti i vlerësimit të ndikimit të projektit në mjedis sipas përcaktimeve të ligjit respektiv.

Ligji Mjedisor janë ligjet për mjedisin, duke përfshirë ligjet që lidhen me përdorimin e tokës, planifikimin, vlerësimin e mjedisit, trashëgiminë mjedisore dhe ujore, ujëmbledhësit, lumenjtë, detet, shtretërit e deteve, bregdetit, plazheve, ajrin, dheun, ujin dhe ujërat nëntokësore, zhurmat, terrenin, kimikatet, pesticidet, lëndët e rrezikshme, shtresën e ozonit, mbeturina, materiale të rrezikshme, rregullimin e ndërtimit, zënien e ndërtesave, shëndetin publik, sigurinë në punë, rrezikun për mjedisin ose çdo aspekt të mbrojtjes së mjedisit.

Kapital është kapitali i shoqërisë së projektit, që i përket aksionerëve në lidhje me investimet e tyre në shoqërinë e projektit, duke përfshirë edhe borxhin për huatë e marra nga aksionerët ose nga një filial i shoqërisë, por vetëm deri në masën që kjo hua është marrë për të garantuar huatë e marra si pasojë e dokumenteve financiare si dhe për kreditë afatshkurtra (bridge loan).

Ligji i Shpronësimeve: Ligji nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”

Certifikata finale e përfundimit është vërtetimi që lëshohet nga Autoriteti Kontraktues sipas pikës 15.2.

Mbyllja Financiare është data, jo më vonë se 18 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës, kur konçesionari konfirmon me shkrim në formën e përcaktuar në Aneksin D (Formulari i Njoftimit të Mbylljes Financiare).

Raporti Financiar është raporti i parashikuar në 7.3.

Dokumente Financimi është çdo Kontratë huaje, obligacion, kontratë sigurimi apo titujsh, hipotekat, trustet, kontratat e kredive, nota ose kontratat për blerje obligacionesh, kontratë pjesëmarrje dhe çdo dokument tjetër në lidhje me financimin, projektimin, prokurimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e impianteve, përfshirë kontratat e blerjes së energjisë elektrike dhe për ushtrimin e të drejtave të konçensionit, përfshirë çdo ndryshim, shtesë, zgjatje kohore dhe zëvendësim për financime të tilla.

Force Majeure është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë palët të përmbushin detyrimet e tyre sipas kontratës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të palës, e cila nuk ka pasur mundësi të shmange një akt ose një ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.

Praktikë e Mirë Industriale është veprimi në mirëbesim për të përmbushur detyrimet me aftësinë dhe kujdesin e duhur në përputhje me kriteret ligjore dhe ato të praktikave të mira ndërkombëtare në industrinë e energjisë elektrike në përgjithësi, dhe ato të industrisë hidroelektrike në veçanti, në lidhje me projektimin, ndërtimin, operimin apo mirëmbajtjen e impiantit hidroelektrike, siç mund të pritet normalisht nga një kontraktor me aftësitë dhe përvojën e duhur, inxhinier ose operator, si rast mund të jetë, nën të njëjtën rrethanë ose të ngjashme.

Të Dhënat e Qeverisë do të thotë të gjitha të dhënat dhe informacioni që:

- a) kërkohen ose do të kërkohen me arsye, nga Konçensionari, për zbatimin e projektit dhe/ose përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, dhe
- b) Autoriteti Kontraktues apo ndonjë organ shtetëror i posedon dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, është i detyruar të vendosë në dispozicion të çdo pale të interesuar që ka një interes të ligjshëm, përfshirë edhe Konçensionarin.

Organ Shtetëror nënkupton:

- a) Qeveria e Republikës së Shqipërisë, apo ndonjë Ministri, departament apo nënndarje organizative e e saj,
- b) Çdo organ tjetër shtetëror, agjenci apo autoritet publik nën kontrollin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë apo ndonjë departament tjetër apo organi i administratës publike, ose subjektet publike, agjencitë apo ndonjë autoritet apo nënndarje politike të saj që ka juridiksion sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë ndaj konçensionarit, ose
- c) Çdo organ i pushtetit vendor brenda Republikës së Shqipërisë. Për shmangien e dyshimit “kontrollit të tërthortë” do të përfshihet nën mbikëqyrjen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Rrjeti i energjisë elektrike është tërësia e linjave, nënstacioneve, pajisjeve të transmetimit apo shpërndarjes së energjisë elektrike, përfshirë linjat e interkonjeksionit.

Kodet e Rrjetit do të thotë Kodi i Transmetimit dhe Kodi i Shpërndarjes

Nioftimi nër Rritien e Shenzimeve ka kuptimin sinas nën 6.6.

Informacioni është tërësia e të dhënave të ofruara deri në datën e kësaj kontrate nga Konçensionari, në lidhje me:

- a) Këtë Kontratë dhe/ose
- b) Projektin dhe/ose
- c) Aftësinë e konçensionarit për të ndërmarrë dhe realizuar projektin në përputhje me këtë Kontratë.

Kapaciteti i Instaluar është kapaciteti total i të gjitha impianteve, shprehur në kW, siç parashikohet në Aneksin A.

Kërkesat e Sigurimit janë kriteret në lidhje me llojet e sigurimeve që kërkohen nga Konçensionari sipas Nenit 20.

M.m.n.d. do të thotë metra mbi nivelin e detit.

Veprim Shtetëror në Kundërshtim me Kontratën është:

- a) (i) shpronësimi, rekuizimi, konfiskimi apo shtetëzimi i impianteve, i aksioneve të shoqërisë konçensionare ose të të drejtave të konçensionit, që realizohen në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit në fuqi;
(ii) Çdo ndalim apo kushtëzim në marrjen dhe transferimin e përfitimeve apo të ardhurave të konçensionarit, kapitalit apo borxheve (sipas dokumenteve financiare) jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (përfshirë ndalimin dhe kufizimin e këmbimit jashtë shtetit).
- b) Dështimi i Autoritetit Kontraktues ose i një organi tjetër shtetëror për të bërë të disponueshëm sheshin e ndërtimit apo t'i garantojë Konçensionarin, në mënyrë të arsyeshme në përputhje me përgjegjësitë e veta ligjore, të drejtat reale të pronësisë në përputhje me këtë kontratë ose të sigurojë Konçensionarin, në mënyrë të arsyeshme në përputhje me përgjegjësitë e veta ligjore, që Konçensionari të ketë gëzimin e qetë të sheshit gjatë gjithë kohës së kontratës dhe deri në fund të Periudhës së Konçensionit.
- c) Kufizime ose masa me efekt të ngjashëm në lidhje me punësimin e personelit të nevojshëm në Shqipëri, të kryera në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, të cilat kanë ndikim negativ në punën e Ndërtimit. Në rast se qeveria parashikon kritere shtrënguese për lëshimin e lejeve të punonjësve të cilat i aplikon në të gjitha shoqëritë e ngjashme me Konçensionarin, këto kritere nuk do të konsiderohen masë me efekt negativ.
- d) Çdo kufizim ligjor që ndalon Konçensionarin të shesë apo të eksportojë një pjesë të prodhimit brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, përveç kufizimeve të parashikuara në këtë Kontratë dhe/ose legjislacionin në fuqi;
- e) (i) çdo veprim ose mosveprim i pajustificuar i kujtdo organi shtetëror si rezultat i të cilit volumi mesatar i ujit të disponueshëm për prodhim energjie pakësohet në krahasim me sasitë e parashikuara në ofertë, ose (ii) Çdo kufizim i pajustificuar, nga i kujtdo organi

shtetëror, i sasisë së ujit që përdoret për qëllimet e pikës (i) të mësipërme, për secilin nga impiantet dhe/ose në kohën e prodhimit;

Kritere Teknike Minimale janë ato kritere të përcaktuara në Aneksin A

Prodhim Neto i Energjisë Elektrike është e gjithë Energjia Elektrike e transmetuar nga Impianti në Pikën e Lëvrimin nga Konçensionari, në çdo kohë deri në mbarimin e Periudhës së Konçensionit, sipas përcaktimit në legjislacionin përkatës.

Të ardhurat Neto janë të ardhurat e përfituara nga Konçensionari gjatë një viti kalendarik nga:

- a) Shitjet e prodhimit (minus kostot për kryerjen e shitjeve të tilla) dhe
- b) Shitjes së certifikatave të gjelbra apo të produkteve të ngjashme (minus kostot për kryerjen e shitjeve të tilla).

Faza e Operimit është periudha që fillon në datën e Përfundimit Paraprak dhe pas vënies në punë të çdo hidrocentrali dhe përfundon në ditën e fundit të Periudhës së Konçensionit gjatë të cilës kryhet operimi tregtar i Hidrocentralit dhe prodhohet Energji Elektrike.

OST është shoqëria OST SHA (Operatori i Sistemit të Transmetimit) (ose një shoqëri tjetër që e pason), e cila është operatori i Sistemit të Transmetimit i autorizuar për transmetimin e energjisë elektrike të Republikës së Shqipërisë.

Teste të Vënies në Punë (Performance) janë teste të specifikuara në nenin 15.1.

NjzP është Njësia e Zbatimit të Projekteve

Impiant apo **Impiantet** janë hidro-impiane ose impiane të ndërtuara nga Konçensionari në lumin Vjosa.

Risku Politik është çdo veprim nga ana e një organi shtetëror që:

- a) Përbën abuzim të pushtetit qeveritar, ose është diskriminues nga vetë natyra apo efekti që krijon ose është i papajtueshëm me legjislacionin në fuqi në lidhje me operatorët e mëdhenj të energjisë
- b) Krijon pengesa antiligjore dhe/ose i shkakton dëm konçensionarit në realizimin e objektit të kësaj kontrate.

Faza Para-Ndërtimore do të thotë periudha kohore që fillon nga Data e hyrjes në fuqi të kontratës dhe përfundon në Datën e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit.

Kontratat e Fazës Para-ndërtimore janë kontratat ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe konçensionarit gjatë fazës para-ndërtimore.

Ndotje Mjedisore Ekzistuese janë ndotjet e mjedisit të bëra nga njeriu, përfshirë depozitimin e mbeturinave dhe grposjen e municioneve apo armatimeve, që ekzistojnë në Shesh në datën ose

para datës në të cilën rreziku transferohet nga Autoriteti Kontraktues ose ndonjë organi tjetër shtetëror për llogari të tij tek Konçensionari (qofshin apo jo të identifikuar në Studimin e mjedisit).

Përfundim Paraprak i Punimeve do të thotë se në lidhje me secilin impiant, Konçensionari ka njoftuar me shkrim Autoritetit Kontraktues se ndërtimi i impiantit ka përfunduar, dhe se mund të fillojnë testet e performancës.

Projekt është projektimi, financimi, ndërtimi, operimi, mirëmbajtja dhe transferimi i pronësisë së impianteve tek Autoritetit Kontraktues.

Kostot e Parashikuara të Investimeve janë kostot totale të investimeve që do të kryhen nga Konçensionari me vlerë prej 14,134,724,113 ALL (pa TVSH) dhe 17,359,502,382 ALL (duke përfshirë Fondin Rezerve dhe TVSH-ne), sipas Aneksit B.

Forca Madhore e Tejzgjatur është një ngjarje e forcës madhore e cila:

- a) Zgjat më shumë se dymbëdhjetë muaj me radhë nga data e fillimit, ose, nëse është e qartë se ajo do të zgjasë për këtë periudhë kohe të paktën gjashtë muaj nga fillimi i saj
- b) Bën realizimin e projektit ekonomikisht të paleverdishëm për konçensionarin (madje edhe duke marrë parasysh të ardhurat e sigurimit sipas Nenit 23.2.)

Koncepti i propozuar (studimi fizibilitetit pjesë e ofertës) ka kuptimin që i është dhënë në Aneksin A.

Zyra e Pasurive të Paluajtshme është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) në Republikën e Shqipërisë.

Të drejtat Reale të Pronësisë janë ato të drejta që mundësojnë gëzimin dhe dispozicionin e plotë dhe ekskluziv të shesheve dhe objekteve të lidhura me to që i transferohen konçensionarit për qëllimin e realizimit të Projektit.

Marrëveshja e Uzefruktit është marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor (ose një organi të pushtetit vendor) dhe Konçensionarit për përdorimin të asaj pjesë të sheshit që nuk është pronë private, sipas referimeve të pikës 6.2.4.2 (a) dhe në zbatim të Neneve 232 e në vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Materialet e Nevojshme për Ndërtim janë, rëra, agregatët, gurët, shkëmbinjtë, zhavorri, druri, ujërat e shirave dhe burimeve, uji i lumit dhe materiale të tjera ndërtimi të nevojshme për realizimin e projektit.

Aksioner/Ortak do të thotë çdo person, fizik a juridik, që zotëron aksione/kuota në Shoqërinë Konçensionare.

Shesh do të thotë sheshi që gjendet në rrjedhën e poshtme të Lumit Vjose, në përputhje me termat e referencës të përcaktuara në Dokumentat Standarde, përfshirë zona të cilat do të qëndrojnë në mënyrë të vazhdueshme ose herë pas here nën ujë ose zona për nxjerrjen e lëndëve të nevojshme për ndërtim, në atë masë që Konçensionari e ka të nevojshme për të ndërtuar infrastrukturën e duhur në përputhje me këtë kontratë, të drejtat mbi tokën dhe servitutet për:

- a) Linjat e transmetimit;
- b) Infrastrukturën e transportit, duke përfshirë rrugët dhe urat e ndërtuara për realizimin e projektit.

Kostot për marrjen e Shesheve janë të gjitha shpenzimet (përfshirë edhe shpenzimet e arsyeshme për këshillim) e realizuara nga Konçensionari për shpronësimin e ndonjë pjese toke që nuk janë në pronësi të Autoritetit Kontraktues, ndonjë Organi Shtetëror, Republikës së Shqipërisë ose ndonjë prej organeve të pushtetit vendor, shpenzime të cilat përballohen nga Konçensionari.

Dokumentacioni për Sheshin është dokumentacioni që i nevojitet Autoritetit Kontraktues për të vënë në dispozicion të Konçensionarit parcelat e shesheve sipas nevojave të fazave të realizimit të projektit, përfshirë dokumentacionin dhe informacionin mbi shpronësimet e nevojshme si dhe identifikimin e saktë të pasurive që duhet të shpronësohen.

Tatim do të thotë çdo taksë, detyrim, tatim, tarifë, pagesë, taksë doganore ose tarifë e çdo lloji, e ngarkuar, e vënë, e vendosur, e kërkuar ose mbledhur, drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga çdo Entitet Shtetëror sipas ligjit, duke përfshirë çdo taksë malli dhe shërbimi, taksë pullash e vulash, tarifë importi, taksë mbi të ardhurat (qoftë mbi të ardhurat, dividendët, pagesat e interesit, tarifën mbi qiratë e pajisjeve ose të tjera), taksë mbi huatë në monedhë të huaj ose transaksione këmbimi me jashtë, taksë akcize, taksë mbi pronësinë, tarifë regjistrimi ose liçensa, duke përfshirë çdo interes, sanksion ose shtesa të tjera mbi to.

Ekspert Teknik dhe Ekonomik do të thotë ekspert i caktuar bashkërisht nga Palët për qëllime pajtimi në zbatim të procedurave të zgjidhjes së kontratave sipas nenit 24.2.

Periudha e koncesionit është afati kohor 35 vjet, duke filluar nga hyrja në fuqi e kontratës

Njoftimi për zgjidhjen do të thotë, një njoftim i kryer nga njëra Palë për Palën tjetër ku deklarohet se Kontrata do të ndërpritet/zgjidhet duke njoftuar edhe shkakun për ndërprerjen/zgjidhjen e saj, të parashikuar shprehimisht në këtë kontratë.

Linja e transmetimit janë strukturat e rrjetit të transmetimit me tension të lartë që lidhin secilin impiant me Pikën e Shpërndarjes, të ndërtuara nga Konçensionari, të cilat i dorëzohen OST-së, dhe do të jenë pjesë të rrjetit kombëtar sipas një marrëveshjeje mes palëve.

Autoriteti Shqiptar i Ujërave dhe Baseneve është Këshilli i Basenit Ujëmbledhës të Vjosës.

Punime do të thotë çdo përgatitje e terreneve apo shesheve dhe punimet e ndërtimit (për aq sa e aplikueshme) që duhet të kryhen në çdo shesh me qëllim realizimin e objektivave të projektit.

Njoftim Mos përmbushjeje ka kuptimin e referuar në Nenin 15.3.

1.3. Interpretimi

Përveç kur nuk kërkohet ndryshe në këtë Kontratë:

- a. Fjalët në secilën gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjënjë;
- b. Fjalët që përdorin numrin njëjës ose shumës përfshijnë gjithashtu respektivisht numrin njëjës ose shumës;
- c. Termat “të kësaj”, “këtu”, “nëpërmjet kësaj ose nga kjo”, “në këtë” dhe fjalë të ngjashme i referohen Kontratës në tërësi dhe jo ndonjë Neni, Paragrafi, Tabele, Aneksi ose Grafiku apo ndonjë nënndarje tjetër të kësaj Kontrate;
- d. Deklarata Hyrëse dhe Anekset, Tabelat dhe Bashkëlidhjet e kësaj Kontrate do të përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate dhe referencat në Aneksin, Tabelat dhe Bashkëlidhjet do të jenë referenca në Aneksin, Tabelat dhe Bashkëlidhjet e kësaj Kontrate, përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe;
- e. Referencat në ndonjë akt përfshijnë çdo ndryshim ose ri-nxjerrje të atij akti, si dhe çdo rregull ose rregullore të nxjerrë në zbatim të këtij akti; dhe referencat në një ligj do të thotë referencë në një ligj të tillë, siç mund të jetë ndryshuar ose rinxjerrë a ribërë;
- f. Fjalët “përfshin” ose “duke përfshirë” do të konsiderohet se pasohen nga [fjalët] “pa kufizim” ose “duke mos u kufizuar në”, edhe nëse ato ndiqen ose jo nga fraza ose fjalë të tilla të ngjashme;
- g. Referencat në “këtë kontratë” ose “kjo Kontratë Konçensionare” ose çdo kontratë ose dokument tjetër do të interpretohen si referenca në këtë kontratë ose dokument, siç ndryshohet, modifikohet ose shtohet, dhe që janë në fuqi nga koha në kohë, si dhe do të përfshijnë referencën në çdo dokument që e ndryshon, modifikon ose e shton atë, ose që është lidhur, bërë ose dhënë në zbatim ose në përputhje me kushtet e saj.
- h. Sa herë që kjo Kontratë i referohet një numri të “ditëve”, ky numër do t’i referohet ditëve kalendarike me përjashtim të rasteve kur specifikohet sa janë ditët e punës;
- i. Çdo reference në një “muaj” apo në një “vit” do të interpretohet si një referencë për një muaj kalendarik apo vit kalendarik;
- j. Çdo fjalë, term, frazë dhe shkurtime që fillon me shkronjë të madhe e përdorur specifikisht në ndonjë Aneks apo Dokument tjetër bashkëngjitur do të ketë kuptimin e përcaktuar në këtë Aneks apo Dokument sipas rastit;
- k. Në rast mospërputhjeje midis ndonjë fjale me gërmë të madhe, termi të përcaktuar, frazë ose shkurtime të parashikuar në Nenin 1.2 dhe një dispozite, fjale me gërmë të madhe, termi, frazë ose shkurtime i parashikuar gjetkë në këtë Kontratë, Aneks ose në një

Dokument tjetër bashkëngjitur, kuptimi i dhënë në Nenin 1.2 do të ketë përparësi, përveç kur konteksti i kësaj Kontrate e kërkon ndryshe;

- l.** Në rast të një konflikti midis kësaj Kontrate dhe anekseve, Palët do të përpiqen, në radhë të parë, për të zgjidhur konfliktin duke lexuar këtë kontratë si një të tërë dhe përparësi kanë dispozitat që janë më specifike. Në qoftë se konflikti vazhdon pavarësisht përpjekjeve të Palëve për ta zgjidhur me mirëkuptim, atëherë parashikimi në kontratë do të prevalojë;
- m.** Krerët e seksioneve në këtë Kontratë dhe në Tabelën e Përmbajtjes kanë për qëllim të lehtësojnë leximin e saj dhe nuk ndikojnë në asnjë mënyrë në interpretimin e kësaj Kontrate.

Pa cenuar paragrafin e mësipërm, në qoftë se ka ndonjë konflikt apo mospërputhje ndërmjet: i) dispozitave të kësaj Kontrate dhe ii) Anekseve të saj, konflikti apo mospërputhja do të zgjidhet në rendin e mëposhtëm të përparësisë:

1. Dispozitat e kësaj Kontrate;
2. Çdo Aneks i kësaj Kontrate;
3. Kërkesat e Autoritetit Kontraktues në procedurën konkurruese;
4. Oferta e Konçensionarit;

NENI 2 - OBJEKTI I KONÇENSIONIT



Me anë të kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues, i autorizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bazë të Ligjit Nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, VKM nr. 576, datë 10.7.2013 "Për miratimin e rregullave për identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve për hidrocentralet" dhe VKM nr. 677, datë 29.7.2015 "Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Poçem", i jep Konçensionarit me koncesion të formës B.O.T (Build – Operate – Transfer që do të thotë ndërtim, operim dhe transferim i së drejtës së operimit, në përfundim të kontratës së konçensionit), financimin, projektimin, vënien në punë, administrimin dhe mirëmbajtjen me koncesion të hidrocentralit Poçem mbi lumin Vjosa, si dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës nga Konçensionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

NENI 3 - KARAKTERISTIKAT E HIDROCENTRALIT

3.1. Hidrocentrali Poçem

Hidrocentrali Poçem do të ndërtohen vendin e quajtur Poçem, rrjedhën e poshtme te Lumit Vjose ne kuote operimi 72 m.n.m.d (bjefi i poshtëm i HEC Kalivaç), me këto karakteristika të përgjithshme.

- **Fuqia e instaluar (kW) -** **N = 99,500 kW**
- **Energjia mesatare vjetore kWh -** **E = 305,393,504.70 kWh/vit.**

Përlllogaritja e sasisë së Energjisë Mesatare Vjetore bazohet ne metodologjine sipas studimeve te detajuara inxhinierike te Projektit te Zbatimit.

3.2. Kushtet hidroteknike dhe te tjera qe duhen respektuar

- Diga duhet te përmbushë kërkesat e ICOLD (Komisioni Ndërkombëtar i Digave te Mëdha) dhe KKDM (Këshilli Kombëtar i Digave të Mëdha)
- Të respektohet vartësia e regjimit të punës të objekteve ekzistuese, niveli i ujit në rezervuar nuk duhet të krijojë probleme apo dëmtime në hidrocentralin e mësipërm ekzistues ose në prona të tjera.
- Gjatë studimit për shfrytëzimin e potencialit energjetik të këtij lumi, të azhurnohen dhe të merren parasysh, infrastruktura rrugore në këtë segment, rrjeti vaditës, burimet si dhe rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm të zonës në studim, të cilat janë ekzistuese dhe ndikohen nga ky projekt, duke respektuar standardet dhe kushtet teknike në lidhje me to si me poshtë:
- Te mos çenohen burimet ekzistuese të ujit te pijshëm apo veprave te tjera te ujitjes apo te kullimit qe mund te ndikohen nga ndërtimi i këtij hidrocentrali nën apo mbi digë si stacioni i pompimit (Poçem, Kute, Fratar dhe Kanalet e ujitjes dhe kullimit etj, por pa u kufizuar ne to) si:
 - a) stacioni i pompimit të Poçemit, i cili furnizon aktualisht me ujë te pijshëm qytetin e Ballshit dhe 11 fshatrave të tjerë të krahinës të Mallakastrës me rreth 35,000 banorë si dhe Uzinën e Përpunimit të Thellë të Naftës në Bashkinë e Ballshit.
 - b) stacioni i pompimit të Kafarajt, i cili furnizon aktualisht me ujë të pijshëm qytetin e Fierit, zonën industriale të këtij qyteti, si dhe fshatrat e tjerë te zonës.
 - c) në kuotën 50 m m.n.d., ekziston stacioni e pompimit me puse shpimi për furnizimin me ujë të fshatrave të njësisë administrative Kutë dhe njësisë administrative Fratar (rreth 10,000 banorë). Aktualisht po zbatohet një investim për ndërtim ujësjellësi nga i cili do të marrë ujë dhe fshati Çorrush – Anbreg. Parashikohet që popullsia që do të përfitojë me furnizim me ujë nga projektet e ndërmarrjes se ujësjellësit do te shkoje ne rreth 50,000 banorëve.

- Gjatë studimit për shfrytëzimin e potencialit energjetik brenda zonës ku parashikohet të ndërtohet objekti HEC "Poçem", ofertuesi duhet të mos cënojë:
 - a) Termat Antike në fshatin Rrexhepaj - Gorisht, Vllahine, Vlore, me status monument kulture kategoria e parë, shpallur nga Ministria e Kulturës Rinise dhe Sporteve me nr. 155, datë 04.04.2002.
 - b) Dy banesat me status monument kulture kategoria e parë:
 - Banesa e Murat Xhelilit, në Dushkarak, Vlore.
 - Banesa e Selim Shehajt, në fshatin Kute, Mallakastër.
- Të mos cenohen kërkesat për ujë, nga ndërtimi i hidrocentralit të Poçemit. Bazuar në skemat ujitëse ekzistuese, potencialisht në ujërat e lumit Vjosë, ujërat rreth 40,000 ha tokë bujqësore të Myzeqesë së Vlorës dhe Fierit. Në këto kushte, aktiviteti bujqësor i rreth 40-50 mijë fermerëve është i lidhur me burimin ujor lumin Vjosë.
- Skema e ujitjes mbi lumin Vjosë janë vepra marrje dhe me stacione pompimi, ku ndër më kryesoren përmendim skemën ujitëse Vjosë-Levan-Fier, me kapacitet 28 m³/sekondë, që mbulon me ujë rreth 20,000 ha në zonën e Fierit.
- Duke marrë në konsideratë mundësinë e futjes në punë edhe të stacioneve të pompimit dhe një sërë skemash të vogla ujitëse, me burim ujor pjesën e poshtme të lumit të Vjosës, (në përputhje me Projektin) kërkesat për ujë për ujë direkt nga rrjedha e lumit Vjosë, në periudhën fillim maji – fund gushti variojnë 40-50 m³/sekondë, me kërkesën pik në periudhën 15 korrik – 15 gusht.
- Gjithashtu duhet marrë në konsideratë zëvendësimin ose plotësimin me skema ujitëse të pjesës mbi digën e hidrocentralit, duke përdorur ujë nga ujëmbledhësi por jo me shume se 2 m³
- Te zëvendësojë të gjithë infrastrukturën ekzistuese (rrugore, elektrike, ujësjellës, ujë, etj.) nëse ndikohet nga Projekti, duke siguruar standardet të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse (përveç rrugëve të kantierit për ndërtimin e hidrocentralit).
- Nëse pjesë të rrugë-s(ve) ekzistuese përmblyhen nga ujëmbledhësi, Konçesionari detyrohet të ndërtojë me kostot e veta këto rrugë dhe veprat e artit që ndikohen si pasoje e zbatimit të projektit, për të mundësuar lëvizjen e komunitetit . Standardi i rrugëve që do të ndërtohen do të jenë i njëjtë me standardin e aplikueshëm për ndërtimin e rrugëve të reja me karakteristika të ngjashme me rrugët ekzistuese ose me të mira.
- Në shfrytëzimin e burimeve ujore për hidroenergjë të zbatohet ligji për rezervat ujore i cili përcakton sipas përparësisë: përdorimin e ujit për pirje; për ujë, bujqësi e akuakulturë; për prodhim hidroenergjie;etj.
- Gjithashtu të respektohet ligji për Mbrojtjen e Mjedisit.

- Të respektohet sasia e ujit ekologjik që do të lihet pa u shfrytëzuar në shtratin e lumit në respektim të ligjit Nr. 111/2012, “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE”

NENI 4 - PERIUDHA E KONCESIONIT

4.1. Periudha e koncesionit

Koncesioni jepet për një periudhë prej 35 (tridhjetepesë) vjetësh duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës së Koncesionit dhe përfundon në ditën e përvjetorit të 35-të kësaj date (“Periudha e Koncesionit”). Megjithatë, në rastin e Zgjidhjes, përpara afatit 35 vjeçar, Periudha e Koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet tek periudha që fillon nga Data e hyrjes në fuqi të kontratës dhe mbaron në Datën e Zgjidhjes.

4.2. Rastet e zgjatjes së Periudhës së Koncesionit:

4.2.1. Palët mund të bien dakort se për shkaqe që ndikojnë drejtpërdrejt në Projekt (jo të shkaktuara nga Konçesionari) Periudha e Koncesionit mund të zgjatet, në përputhje me kohën e duhur që projekti të konsiderohet si rentabël dhe financiarisht i përshtatshëm në përputhje me analizat financiare të “ Vlerës përPara”, “IRR ”apo çdo lloj analize tjetër të përditshme për vlerësime të tilla.

4.2.2. Palët bien dakort që vonesat e gjata dhe të paarsyeshme, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të krijuara nga Autoriteti Kontraktues dhe/ ose çdo Enti Shtetëror në pajisjen me Leje, Licenca dhe/ose Autorizime, do të shërbejnë si shkak që palët të negociojnë për shtyrjen e Periudhës së Koncesionit. Në çdo rast shtyrja e afatit duhet të behet me dakortësinë e palëve dhe të materializohet me nënshkrimin e shtesës respektive të kontratës. Afati i shtyrjes do të jetë i barabartë me kohën e vonesës së shkaktuar.

Per te shmangur çdo dyshim, Palët bien dakord që, në këtë rast, vonesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues dhe/ ose çdo Enti Shtetëror për pajisjen me Leje, Licenca dhe/ose Autorizime, nuk do të konsiderohen mos përmbushje të Autoritetit Kontraktues dhe/ose Veprim Shtetëror në Kundërshtim me Kontratën.

4.2.3. Palët bien dakort se Periudha e Koncesionit do të zgjatet në rastin e një Ngjarjeje të Forcës madhore, për një periudhë kohe të barabartë me kohën që ka zgjatur Ngjarja plus kohën e arsyeshme që nevojitet për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga ngjarja. Në rast të një pashmangshmërie teknike/detyrimi teknik, e cila kërkon më shumë kohë për të analizuar/testuar dhe/ose për të zgjidhur problemin (të tilla si problemet gjeologjike ose hidrogeologjike, të cilat mund të kërkojnë teste të thelluara apo analiza që nuk mund të përfundojnë në një kohë të shkurtër), Konçesionari ka të drejtë të

aplikojë për zgjatje të Periudhës Koncesionare. Autoriteti Kontraktues do të zgjasë Periudhën Koncesionare nëse arsyeja e prezantuar nga ana Konsensionarit është e vlefshme dhe ka ndodhur jo për gabimin/fajin/dështimin e Koncesionarit

KREU II

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

NENI 5 - TË DREJTAT E KONCESIONIT

5.1 Sipërmarrja e Përgjithshme

Palët kanë detyrimin të bashkëpunojnë, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, për zbatimin e projektit, në mënyrë eficiente dhe sa më shpejt që të jetë e mundur. Autoriteti Kontraktues angazhohet që të ndërmarrë hapat e nevojshëm dhe të sigurojë bashkëpunimin dhe mbështetjen e të gjitha Organeve shtetërore apo të pushtetit vendor, për marrjen e Lejeve të nevojshme me qëllim realizimin e projektit

5.2 Dhënia e të drejtave të Koncesionit

5.2.1. Duke filluar nga Hyrja në Fuqi, Autoriteti Kontraktues i jep koncesionarit, i cili pranon, të drejtat ekskluzive, për të gjithë Periudhën e Koncesionit, për:

- a) projektimin, financimin, ndërtimin, testimin, dhe operimin/përdorimin e impianteve;
- b) të drejtën për Gëzim të Qetë të aseteve të këtij projekti objekt i rregullimeve të nenit 5.3
- c) të përputhje me nenin 5.3, aksesin në/dhe përdorimin e ujit të pjesës së poshtme të lumit Vjosë, midis lartësive 72 dhe 38 brenda kufijve gjeografikë.
- d) të shesë dhe të furnizojë me Prodhim Neto të Energjisë Elektrike, jo vetëm palët e treta me të cilët hyn në marrëdhënie kontraktore në Republikën e Shqipërisë por edhe operatorë të tjerë jashtë saj, të mbledhë dhe të përfitojë të ardhura nga ky aktivitet me kusht që:
 - (i) Koncesionari të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për prodhimin, transmetimin dhe shitjen e energjisë elektrike gjatë aktivitetit të tij; dhe
 - (ii) Koncesionari të përmbushë detyrimin e shërbimit publik, të vendosur në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e

energjisë elektrike";;

- e) T'i kthejë Autoritetit Kontraktues, në mbarim të periudhës së Koncesionit dhe pa pagesë, përdorimin e Sheshit, të drejtën e kalimit dhe t'i transferojë pronësinë hidrocentralit, te impianteve përbërëse të tij, të drejtën e veprimtarisë si dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për këtë qëllim (të gjitha së bashku quhen " Të drejtat e Koncesionit").

5.2.2. Kjo Kontratë Koncesioni përbën një projekt BOT (Build - Operate - Transfer, "Ndërto — Opero — Transfero). Impianti do të regjistrohet në emër të konçesionarit. Pasuritë e paluajtshme brenda Sheshit i njihet dhe regjistrohet në emër të Konçesionarit, sipas ligjit shqiptar mbi regjistrimin e pronave të paluajtshme. Konçesionari mund të lidhë kontrata përkatëse për sheshet apo pasuritë e paluajtshme me qëllim kreditimin nga banka vendase apo të huaja dhe/ose institucione të tjera financiare, për të siguruar pagimin e çdo shume të marrë për financimin e projektit qoftë ndërtimin ashtu edhe operimin e Projektit. Me mbarimin e afatit dhe/ose zgjatjeve eventuale, Konçesionari transferon dhe/ose do të transferojë tek Autoriteti Kontraktues sipas përcaktimit të nenit 27 të kësaj Kontrate.

5.3 Dhënia e pozicionit gjeografik të Shesheve

Pavarësisht përcaktimeve të nenit 5.2 më sipër

- a) Disponimi i Shesheve, e Drejta e Kalimit, Gëzimi i Qetë dhe e drejta për aksesin dhe përdorimin e ujit të pjesës së poshtme të lumit Vjosë, midis lartësive 72 m m.n.d. dhe 38 m m.n.d., përfshirë, i jepet Konçesionarit nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me Ligjin dhe Nenet 265 dhe 277 të Kreut II, Servitutet Detyruese, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Në çdo rast Autoriteti Kontraktues siguron të drejtën e Kalimit për Konçesionarin në toka që janë në pronësinë e shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- b) Në lidhje me disponimin e Shesheve, të Drejtat e Kalimit, Gëzimin e Qetë dhe të drejtat për aksesin e përdorimin e ujit në mënyrën e sipërpërmendur, Konçesionari pranon Sheshet "në kushtet në të cilat ndodhen" që nga data e dhënies dhe Autoriteti Kontraktues nuk do të jetë përgjegjës ndaj Konçesionarit në lidhje me gjendjen e tyre.

5.4 Marrëveshjet dhe Përfaqësimet nga Autoriteti Kontraktues

- 5.4.1. Konçesionari gëzon gjatë Periudhës së Konçesionit, të gjitha të drejtat për akses në Rrjetin Elektrik, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe kuadrin rregullator të miratuar nga ERE dhe rregullat e aplikueshme nga operatorët që operojnë sistemin e transmetimit dhe të shpërndarjes.
- 5.4.2. Gjatë kohëzgjatjes së Periudhës së Konçesionit, Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Entitet tjetër Shtetëror, qendror apo vendor, nuk do të japë askujt të drejta të shfrytëzueshme, devijojnë ose çlirojnë ujë mbi rrjedhën e ujërave që kalojnë në Sheshe, nëse një veprim i tillë mund të shkaktojë (i) zvogëlimin e mesatares ditore, sezonale apo vjetore, të vëllimit të ujit në dispozicion të Shesheve nën vëllimin e nevojshëm për të prodhuar energji elektrike në raport me kapacitetin e instaluar aty, me përjashtim të atyre që janë parashikuar në këtë marrëveshje; ose (ii) rritjen e maksimumit ditor, sezonal apo vjetor të vëllimit të ujit në Sheshe ose në objekte ekzistuese në masë më të madhe sesa sasia e ujit që mund të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike në impiant, me përjashtim të rasteve të diktuar nga rritja e prurjeve natyrore ose (iii) në mënyra të ndryshme, efekte negative në operimin dhe mirëmbajtjen e projektit. Në rastin e një ndryshimi të tillë në pjesën e sipërme të digës, i cili miratohet ose lejohet nga Autoriteti Kontraktues dhe rezultojnë të ketë efekte negative në prodhimin e energjisë, Autoriteti Kontraktues është i detyruar të kompensojë të gjitha humbjet direkte/indirekte që provohen nga ana e Konçesionarit. Për të shmangur çdo dyshim, dhënia nga Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Entitet tjetër Shtetëror, i të drejtave të shfrytëzimit, devijimit, apo çlirimit të ujërave, në përputhje me kushtet e parashikuara në Nenin 3.2, nuk do të përbëjë shkelje të kushteve të kësaj kontrate.

Në rast se Autoriteti Kontraktues ndërmerr ndonjë veprim në shkelje të këtij neni dhe verifikohen pasojat e parashikuara në paragrafët e mësipërme ose dështon në ndërmarrjen e veprimeve që mund të eliminonin këto pasoja, duhet të rivendosë konçesionarin në gjendjen e mëparshme (përfshirë kompensimin për shpenzimet dhe fitimin e munguar). Nëse Autoriteti Kontraktues nuk e rikthen gjendjen e mëparshme brenda 6 Muajve nga data në të cilën Konçesionari ka njoftuar për këto pasoja, kjo rrethanë konsiderohet si shkelje e dispozitave të kësaj kontrate dhe konçesionarit i lind e drejta ta zgjidhë atë dhe të kërkojë likuidimin e dëmeve si pasojë e kësaj shkelje.

- 5.4.3. Autoriteti Kontraktues do të mbështesë në mënyrë të arsyeshme çdo aplikim për Mekanizmin e Zhvillimit të Pastrimit, që mund të paraqitet nga Konçesionari tek autoritetet përkatëse, veçanërisht për marrjen e aprovimit nga Enti Shtetëror përgjegjës për mjedisin me kusht që aplikimi për mekanizmin e zhvillimit të pastrimit të jete hartuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Për të shmangur çdo dyshim, Autoriteti Kontraktues, nuk do të konsiderohet përgjegjës nëse nuk jepet

ky aprovim).

5.4.4. Në çdo kohë gjatë Periudhës së Koncesionit, Autoriteti Kontraktues me kërkesë të Konçesionarit, do të beje përpjekje:

- (a) të ndihmojë Konçesionarin në pajisjen me viza, leje pune dhe të gjitha lejet e tjera të ngjashme që kërkohen nga legjislacioni në fuqi për punonjës të kualifikuar të huaj sipas nevojave të projektit;
- (b) të garantojë dhe lëshojë lejet apo autorizimet të dhëna prej tij dhe do të ndihmojë Konçesionarin, në mënyrë të arsyeshme dhe brenda mundësive dhe fushës së tij të përgjegjësisë, me qëllim që Organi kompetent Shtetëror të lëshojë apo të rinovojë të gjitha Autorizimet, përfshirë ato Autorizimet të nevojshme për ndërtimin e një hidrocentrali, që kërkohen për qëllime të projektit, me kusht që Konçesionari të ketë dorëzuar aplikimet e plota dhe dokumentacionin e nevojshëm, për të gjitha Autorizimet, në kohën e duhur dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Konçesionari duhet të:

1. të veprojë si një Operator i Arsyeshëm dhe i Kujdesshëm për t'i përmbajtur këto autorizime
2. të vazhdojë me zell punën dhe të përmbushë kriteret për mbajtjen e çdo Autorizimi;
3. të informojë, në momentin e kërimit të një autorizimi apo rinovimit të tij, Autoriteti Kontraktues për të gjitha masat e marra dhe veprimtaritë e kryera për këtë qëllim; dhe
4. t'i japë Autoritetit Kontraktues informacionin që ky mund të kërkojë në rastin kur Konçesionari kërkon të shesë energji elektrike në rastet kur ka gjetur blerësin vet, duke respektuar legjislacionin në fuqi për këto veprimtari.
5. Të realizojë ndërtimin e veprës brenda afateve kohore të parashikuara në këtë kontratë.
6. Të marrë masa që të realizojë me cilësi punimet, në përputhje me kushtet dhe specifikimet e kësaj kontrate.
7. Të respektojë të drejtat e komunitetit lokal dhe të mos krijojë pengesa për ta në drejtim të aksesit të infrastrukturës, ujit të pijshëm e vaditës.
8. Të respektojë të gjitha kërkesat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

- (c) Në rastet kur është e mundur për të dhe brenda fushës së tij të përgjegjësisë, Autoriteti Kontraktues me kërkesë të Konçesionarit, mund të ndihmojë apo asistojë këtë të fundit tek subjektet private për çështje që lidhen me pengesat që mund të hasen në kuadër të shpronësimeve apo çdo lloj tjetër veprimtarie që nevojitet për ekzekutimin e punimeve dhe operimin e Projektit. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm kur pengesat krijohen si rezultat i mos përmbushjes së kërkesave ligjore përkatëse nga ana e Konçesionarit.
- (d) të ndihmojë Konçesionarin, në mënyrë të arsyeshme dhe brenda fushës së tij të përgjegjësisë, në marrëdhënie dhe në lidhjen e Kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të Objektivit të kësaj Kontrate.

5.5. Objektet e transmetimit

- 5.5.1. Konçesionari është përgjegjës për ndërtimin e linjave të transmetimit, me shpenzimet e tij sipas Ligjit.
- 5.5.2. Linjat e transmetimit të ndërtuara nga Konçesionari, do të lidhen në rrjetin e transmetimit në pikat më të përshtatshme dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi dhe në kontratën që Konçesionari do të lidhë me OST.

5.6. Krijimi i zonave të sigurisë

Nga **Data e Fillimit të Punimeve** deri në mbylljen e Portës për krijimin e rezervuarit të hidrocentralit, prurjet e mëdha nuk mund të komandohen dhe në këtë rast nuk mban përgjegjësi asnjëra palë, me përjashtim të rasteve kur dëmtimet kanë ardhur si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve të palëve. Pas mbylljes së Portës deri në fund të Periudhës së Koncesionit e gjithë përgjegjësia është e Konçesionarit i cili do të kompensojë palët e dëmtuara. Autoriteti Kontraktues do të përpiqet që organet shtetërore kompetente të krijojnë “zona sigurie” siç propozohet nga Konçesionari; nëse këto zona krijohen me kërkesë të konçesionarit ky i fundit përballon kostot e lidhura me to. Këto kosto, lidhen me dëmet që mund t'i shkaktohen palëve të treta si pasojë e ndërtimit dhe operimit të objektit të koncesionit.

5.7. Ujërat e mbetura/ ujitja

Dëmet apo humbjet e pësuar nga Konçesionari, si rezultat i Ndryshimit të Ligjit që ka për pasojë rritjen e sasisë së ujit që duhet të lëshohet për përdorim civil apo ujitje, do të përballohen tërësisht nga Enti shtetëror përkatës që ka shkaktuar këtë dëm ose humbje. Përlllogaritja e sasisë së ujit të përdorur, të fuqisë së instaluar dhe energjisë së prodhuar do të rishikohet ndërmjet palëve në rast ndryshimi të sasisë së përdorimit nga Informacioni i dhënë nga KKKU.

NENI 6 - FAZAVE PARA- NDËRTIMORE

6.1. Njësia e Zbatimit të Projektit (NJZP)

6.1.1. Brenda tre muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi e kësaj Kontrate, Palët krijojnë Njësinë e zbatimit të Projektit, e cila përbëhet nga shtate anëtarë që caktohen si më poshtë ("NJZP"):

- (a) Katër anëtarë të caktuar nga Autoriteti Kontraktues; dhe
- (b) Tre anëtarë, përfaqësues të nivelit të lartë drejtues të Konçesionarit.

Çdo anëtar i NJZP ka të drejtë të ftojë persona të tjerë si vëzhgues të ftuar, për të marrë pjesë në takimet e NJZP, nëse ata e shikojnë të arsyeshme.

6.1.2. NJZP-ja mbikëqyr dhe koordinon aktivisht përmbushjen, nga Palët, të detyrimeve të tyre respektive të çdo faze (para-ndërtim, ndërtim, operim) me synimin e përsheptimit të trajtimit të çdo çështje apo konflikti që mund të lindë gjatë kësaj periudhe. Në veçanti ajo do të shqyrtojë çdo propozim për zgjatje të afateve dhe për ndryshime të Projektit, si dhe çdo çështje tjetër të cilën ajo dëshiron ta marrë në shqyrtim në lidhje me Projektin, ose i referohet asaj nga secila prej Palëve.

6.1.3. NJZP-ja mund të lëshojë rekomandime apo t'u japë lajmërimë Palëve sa herë që mund t'i duket e arsyeshme. Gjithsesi, NJZP-ja nuk ka autoritet për të ndryshuar kushtet e kësaj kontrate apo të pezullojë të drejtat e Palëve që rrjedhin prej saj.

6.1.4. NJZP-ja mblidhet në Tiranë, sa herë të jete e nevojshme, por të paktën një herë në dy muaj. Ajo nuk është e detyruar të zbatojë rregulla procedurale të caktuara për njoftimin dhe mbajtjen e mbledhjeve, megjithatë NJZP është e detyruar që të materializojë dhe të administrojë minutat e takimit të të gjitha mbledhjeve dhe komunikimet e palëve për çështje të ndryshme, të cilat mund ti adresohen për ndjekje apo për dhënie mendimi.

6.2. Dispozita të Përgjithshme

6.2.1. Palët do të mbështesin njëra-tjetrën dhe do të bashkëpunojnë me qëllim të realizojnë marrjen e të Drejtave Reale të Pasurive të Paluajtshme, Mbylljen Financiare dhe çdo kontrate tjetër të fazës para-ndërtimore sa më shpejt që të jetë e mundur. Pavarësisht nga afatet kohore ose kohëzgjatjet e përcaktuara në këtë Kontrate, Palët do të ndërmarrin veprime në mënyrë paralele për aq sa do të jetë e mundur.

6.2.2. Palët do të bëjnë përpjekje maksimale për të përfunduar marrjen e të Drejtave Reale të Pasurive të Paluajtshme, Mbylljen Financiare dhe çdo kontrate tjetër të fazës para-ndërtimore sa më shpejt që të jetë e mundur. Palët pranojnë dhe bien dakord se proceset dhe afatet kohore për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në nenin 6.4 nuk mund

të parashikohen me saktësi që nga data e kësaj kontrate për shkak të mbivendosjeve të ndryshme midis proceseve të tilla (duke përfshirë edhe pasojat që çdo shtyrje e afatit të një procesi, qofshin apo jo të parashikuara nga ligji, mund të krijojë pasoja mbi afatet e proceseve të tjera). Për këtë arsye Palët vendosin se : (i) përmbushja e detyrimit nga secila Palë do të gjykohet gjithmonë duke pasur parasysh rrethanat specifike dhe, si rezultat, vonesa e njëres nga palët nuk do të shkaktojë zgjidhjen e kësaj kontrate, si dhe nuk do të krijojë të drejtën për të kërkuar ndonjë pagesë, zbatimin e kushtit penal apo ndonjë dëmshpërblim, nëse vonesa të tilla vlerësohen të justifikuar sipas rrethanave rast pas rasti, dhe (ii) në rast se vonesa të tilla nuk janë pasojë e neglizhencës së konçesionarit, të gjitha afatet kohore për veprimet që pasojnë, të cilat janë logjistikisht të mëpasshme ndaj atyre të sipërpërmendura sipas fazave të Kontratës, zgjatet për aq sa zgjat vonesa e përmendur më sipër Megjithatë, palët duhet të bien dakord për çdo zgjatje e afatit kohor të realizimit të proceseve të ndryshme të projektit dhe duhet të nënshkruajnë shtesën përkatëse të kontratës .

6.2.3. Në varësi të marrjes së të drejtave reale të pronësisë në Sheshe dhe Mbylljes Financiare Konçesionari planifikon të përfundojë fazën para-ndërtimore brenda 24 muajve nga Data Efektive e Kontratës nën kushtet normale të punës.

6.2.4. Të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme janë përcaktuar si më poshtë:

6.2.4.1. Jo më vonë se 8 muaj pas miratimit të projektit të detajuar teknik të zbatimit nga Autoriteti Kontraktues, Konçesionari duhet të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm për të filluar procedurën e marrjes në posedim të ngastrave në gjerësinë gjeografike të Sheshit, duke paraqitur kërkesat e respektive për këtë qëllim.

6.2.4.2. Brenda 3 muajve nga marrja e kërkesës së mësipërme në lidhje me parcelat e Sheshit, Autoriteti Kontraktues vë në dispozicion të konçesionarit, pa pagesë, të gjitha parcelat në pronësi të organeve shtetërore (me përjashtim të tokës në pronësi të organeve të pushtetit vendor) dhe i transferon Konçesionarit, mbi çdo pjesë të Sheshit servitutet apo të Drejta Reale të ngjashme për realizimin e projektit (p.sh. të drejtat e ndërtimit, servitute të tjera dhe të drejtat e kalimit). Për sa i përket pjesët e shesheve në pronësi të organeve të pushtetit vendor Konçesionari do të negociojë direkt me organet në fjalë me qëllim marrjen e të drejtave të sipërpërmendura. Në rast dështimi të këtyre negociatave, Autoriteti Kontraktues, me kërkesën e Konçesionarit, ndihmon në mënyrë të arsyeshme Konçesionarin, për marrjen e këtyre Shesheve sipas përcaktimeve ligjore. Këto të Drejta Reale pronësie në lidhje me Sheshet, do të:

- (a) vërtetohen nga kontrata me shkrim ndërmjet Konçesionarit dhe Autoritetit Kontraktues (ose organit të pushtetit vendor) sipas kushteve në përputhje me këtë Kontratë dhe të pranuar nga të dy palët (Marrëveshja e Uzufuktit). Këto kontrata do të regjistrohen në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në emër të Konçesionarit, siç kërkohet nga legjislacioni shqiptar, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi Marrëveshjeve përkatëse të Uzufuktit.
- (b) Kenë një afat jo me të shkurtër se Periudha e Koncesionit me kusht që, edhe nëse Ligji i zbatueshëm kufizon afatin maksimal të Kontratës së Sheshit, Kontratat e sheshit do të zgjaten, rilidhen apo zëvendësohen me një të re në mënyrë që Konçesionari të ketë gëzimin e plotë të të drejtave reale të pronësisë mbi sheshet deri në përfundim të Periudhës së Koncesionit;
- (c) jenë të lira nga çdo barrë apo interesa të tjera negative, si dhe janë të përjashtuara nga çdo e drejtë e palëve të treta mbi to;
- (d) në çdo kohë e drejta e pronësisë mbi sheshet i përket Autoritetit Kontraktues. Të drejtat e pronësisë nuk mund të lihen peng ose si garanci. Vetëm të drejtat e përdorimit të dhëna për periudhën 35 vjeçare të garantuara në këtë kontratë të Sheshit, mund në masën e lejuar me Ligj, të hipotekohen, lihen peng apo të lihen si garanci tek huadhënësit si sigurim për borxhin që mund të merret nga Konçesionari për realizimin e projektit. Në përfundim të këtij afati sheshet dhe çdo aset do t'i kthehet Autoritetit Kontraktues i çliruar nga çdo barrë ose garanci nga huadhënësi ose palë të treta

6.2.4.3. Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme, që pas kërkesës dhe depozitimit të dokumentacionit të përgatitur nga Konçesionari, të realizojë procedurat nevojshme të shpronësimit me sa më efikasitet të jetë e mundur në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

Në rast se Autoriteti Kontraktues, për faj të tij pas dorëzimit të kërkesës për shpronësim dhe depozitimit të dokumentacionit të plotë nga Konçesionari, nuk arrin të kryejë procedurat përkatëse në përputhje me ligjin, Konçesionari ka të drejtë të paraqesë Njoftim për zgjidhje të Kontratës.

- (a) Parcela të tilla të Sheshit do të jenë të lira nga çdo barrë apo interesa të tjera të palëve të treta;
- (b) Për shmangien e çdo dyshimi, (i) çdo parcelë në çdo Shesh, e shpronësuar sipas ligjit do të konsiderohet e përfshirë në Shesh (edhe për sa i përket

Gëzimit të qetë) që nga data e shpronësimit; (ii) Data e kërkesës nga ana e konçesionarit konsiderohet data në të cilën janë dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara, dhe (iii) Autoriteti Kontraktues ose Organi shtetëror pas plotësimit të gjithë dokumentacionit të nevojshëm nga ana e konçesionarit, pranon kërkesën për shpronësim dhe kryen procedurat e shpronësimit sipas afateve të parashikuara në legjislacionin për shpronësimet,

- (c) Autoriteti Kontraktues që në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësimin, ka fituar titullin e pronësisë mbi tokat e shpronësuara, me kërkesën e konçesionarit, informon menjëherë konçesionarin mbi regjistrimin e titullit të pronësisë për pasuritë pronë private të shpronësuara për interes publik. Sipas shpronësimeve, Konçesionari ka të drejtë të regjistrojë të gjitha të drejtat e përfituara nga Marrëveshja e Uzufuktit mbi sipërfaqen e Sheshit për impiantet dhe për të gjithë strukturat ndihmëse, të shpronësuara nga Autoriteti Kontraktues ose ndonjë organ tjetër shtetëror, për llogari të tij, gjatë gjithë periudhës konçesionare;
- (d) në çdo kohë e drejta e pronësisë mbi sheshet i mbetet Autoritetit Kontraktues. Të drejtat e pronësisë nuk mund të lihen peng ose si garanci. Vetëm të drejtat e përdorimit të tokave të shpronësuara në favor të Konçesionarit mund të hipotekohen, lihen peng apo të lihen si garanci tek huadhënësit si sigurim për borxhin që mund të merret nga Konçesionari për realizimin e projektit, në masën e lejuar nga ligji;
- (e) Të gjitha kostot e procesit të shpronësimit, përballohen nga Konçesionari.

6.3. Mbyllja Financiare

Në varësi të marrjes së të drejtave pasurore mbi Sheshet, Konçesionari është i detyruar që brenda ose me herët se 18 muaj pas Datës së Hyrjes në Fuqi, të sigurojë dhe dorëzojë tek Autoriteti Kontraktues dokumentin që provon se Mbyllja Financiare ka ndodhur, specifikuar në Aneksin D (Formulari i Njoftimit të Mbylljes Financiare)

6.4. Faza para-ndërtimore nën përgjegjësinë e konçesionarit

- 6.4.1. Brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës, Konçesionari duhet të paraqesë për miratim projektin e zbatimit pranë Autoritetit Kontraktues.
- 6.4.2. Me miratimin e Projektit të Zbatimit, Konçesionari duhet të paraqesë menjëherë kërkesat/aplikimet për marrjen e lejeve/liçensave përkatëse të nevojshme për pajisjen me Lejen e Ndërtimit sipas përcaktimit të Legjislacionit në Fuqi. Në rast vonese pa shkak të ligjshëm nga Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Enti tjetër Shtetëror në përmbushjen e afateve të përcaktuara në këtë Kontratë, Konçesionarit i lind e drejta të

kërkojë shtyrje në përmbushjen e afateve të detyrimeve të tij e cila do të jetë e barabartë me kohën e vonesës së shkaktuar. Në rast se konçesionari nuk përmbush afatet e parashikuara në kontratë, ai do të paguaj çdo dëm që i ka shkaktuar Autoritetit Kontraktues përfshirë edhe penalitetet përkatëse.

- 6.4.3. Konçesionari, jo më vonë se 3 muaj para përfundimit të Fazës së Para-Ndërtimit, i dorëzon Autoritetit Kontraktues kopje të certifikatave të sigurimit që vërtetojnë se konçesionari është pajisur me policat e detyrueshme të sigurimit dhe se është i mbuluar për të gjitha rreziqet e fazës së ndërtimit, në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate
- 6.4.4. Brenda 6 muajsh nga data kur Konçesionari ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme për Fazën e Ndërtimit, Konçesionari kryen mbylljen e fazës para ndërtimore dhe në veçanti prokurimin e punimeve të ndërtimit dhe lidhjen e kontratave përkatëse, në mënyrë të veçantë atë të materialeve të ndërtimit. Këto rrethana i njoftohen me shkrim Autoritetit Kontraktues.

6.5. Kontratë të fazës para- ndërtimore nën përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues

- 6.5.1. Autoriteti Kontraktues i dorëzon, pa pagesë, Konçesionarit çdo të dhënë që disponon dhe që është brenda fushës së përgjegjësisë, brenda 1 muaji nga data e paraqitjes së një kërkesë me shkrim, ku argumentohet interesi i ligjshëm për këto të dhëna, me kusht që këto të dhëna të mos përfaqësojnë të dhëna konfidenciale, sekrete tregtare apo të ekzistojë një shkak i ligjshëm që justifikon pamundësinë e dorëzimit të tyre. Të dhënat e organeve të tjera shtetërore do të dorëzohen në përputhje me kushtet dhe procedurat që këto organe zbatojnë.
- 6.5.2. Brenda 1 muaji nga dorëzimi i dokumentacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi, Autoriteti Kontraktues lëshon lejet apo autorizimet që janë në kompetencën e tij dhe ndihmon Konçesionarin (pas një kërkesë nga ky i fundit) që çdo organ shtetëror t'i lëshojë konçesionarit Lejet përkatëse në mënyrë që ky i fundit të fillojë eksplorimin dhe gjetjen e shesheve të përshtatshme dhe të vijojë me realizimin e projektit.
- 6.5.3. Brenda 2 muajsh nga dorëzimi i dokumentacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktues garanton dhe lëshon lejet apo autorizimet e dhëna prej tij dhe ndihmon Konçesionarin (pas një kërkesë nga ky i fundit) që çdo organ shtetëror t'i lëshojë konçesionarit të gjitha autorizimet e nevojshme për fazën e ndërtimit, me kusht që konçesionari të ketë paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara në kohën e duhur dhe përfshirë përgatitjen dhe dorëzimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Gjithashtu, Konçesionari mund të paraqes pranë Autoritetit Kontraktues korrespondencën zyrtare me çdo Ent Publik.
- 6.5.4. Në rastet kur materialet e nevojshme të ndërtimit janë të pranishëm në parcela të Sheshit, siç është përcaktuar në lejen përkatëse të ndërtimit të projektit (leje të Shesheve dhe/ose leje të ndërtimit që lëshohen nga autoritetet kompetente në përputhje

me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi urbanistikën, ndërtimin dhe planifikimin e territorit, Autoriteti Kontraktues lejon, për aq sa është në fushën e tij të përgjegjësisë dhe në përputhje me fushën e kompetencës dhe duke respektuar përcaktimet ligjore edhe përpara datës së fillimit të punimeve të ndërtimit, nxjerrjen, magazinimin dhe përdorimin e këtyre materialeve për qëllimet e projektit.

6.6. Rritja e shpenzimeve

- 6.6.1. Nëse në çdo kohë, pas datës së Mbylljes Financiare, kostot totale të investimit janë rritur me më shumë se 15% të krahasuar me vlerën nominale të investimit të parashikuar, por pa tejkaluar 30%, Konçesionari mund të dorëzojë me shkrim Autoritetit Kontraktues një Njoftim për Rritje Kostosh.
- 6.6.2. Çdo njoftim, për rritje kostosh, duhet të shoqërohet me një propozim, për ndryshimet e mundshme të projektit në mënyrë që konçesionari të vendoset në një pozicion të ngjashëm, me të cilin ai në të cilin do të kishte qenë, nëse shpenzimet e investimit total, nuk do të rriteshin me më shumë se 15%.
- 6.6.3. Maksimumi i rritjes së kostos së investimit mund të jetë 30%.

6.7. Fillimi i fazës ndërtimore

Faza e ndërtimit fillon në datën kur janë marrë të drejtat reale të pronësisë dhe është kryer mbyllja financiare duke përmbyllur kushtet e parashikuara nga nenet 6.4 dhe 6.6. "Data e Fillimit të punimeve të ndërtimit i korrespondon datës së marrjes së Lejes së Ndërtimit". Konçesionari njofton Autoritetin Kontraktues për këtë datë.

NENI 7 - TARI FATI, RAPORTIMI & AUDITIMI

7.1. Tarifa e koncesionit, logaritja dhe pagesa e taksës së koncesionit

- 7.1.1. Pasi të jenë lëshuar Certifikata e përfundimit të punimeve për impiantin përkatës dhe vënies në punë të Hidrocentralit, Konçesionari, sipas zgjidhjes së Autoritetit Kontraktues, do të paguajë në favor të Autoritetit Kontraktues, tarifën e koncesionit në vlerën 2.2% e të ardhurave neto nga prodhimi i energjisë dhe çdo lloj përfitimi që konçesionari ka të drejtë të raportojë në përqindjen e cila përfaqëson tarifën Koncesionare, prodhimi i kësaj energjie elektrike, përfshirë pa limit edhe të drejta prej reduktimit të karbonit dhe të gazrave të tjera në atmosferë.
- 7.1.2. Tarifa e koncesionit (TK) është i vetmi detyrim monetar i konçesionarit ndaj Autoritetit kontraktues përveç sa parashikohet ndryshe në këtë kontratë.

- 7.1.3. Brenda 31 marsit të çdo viti kalendarik, pas lëshimit të certifikatave të përfundimit të ndërtimeve, konçesionari i paraqet Autoritetit Kontraktues llogaritjen e tarifave të konçesionit për vitin kalendarik të mëparshëm sipas pasqyrave financiare të Konçesionarit
- 7.1.4. Autoriteti Kontraktues lëshon faturë për pagesën e tarifës së konçesionit.
- 7.1.5. Konçesionari paguan TK brenda 3 muajve nga lëshimi i faturës. Në rast se detyrimi nuk paguhet brenda këtij afati kohor, Konçesionari do të paguaj kamatëvonesat në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

7.2. Raportimi Financiar dhe Auditimi

Jo më pak se një herë në vit gjatë Periudhës së Konçesionit, 3 muaj pas mbarimit të vitit financiar, konçesionari i paraqet Autoritetit Kontraktues, bilancet financiare të audituara.

NENI 8 - KONCESIONARI DHE INVESTIMET MINIMALE TË KAPITALIT

8.1. Investimet minimale të kapitalit

Aksionerët, dhe çdo aksionar tjetër, japin garanci se kapitali i paguar tek Konçesionari është dhe do të mbetet gjithmonë, të paktën i barabartë 20% (me njëzet për qind) e shumës së shpenzimeve kapitale që nevojiten për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në varësi të kohës kur këto shpenzime kryhen nga Konçesionari.

8.2. Roli i Konçesionarit

- 8.2.1. Konçesionari do të zotërojë impiantet dhe të gjitha asetet që janë pjesë e saj dhe merr përsipër të gjitha detyrimet në lidhje me ndërtimin dhe funksionimin e tyre.
- 8.2.2. Konçesionari garanton se interesat e përfituara nga impiantet nuk do të ngarkohen me barrë përveç për Huadhënësin kur nevojitet të merret financim për ndërtimin apo funksionimin e tyre në përputhje me Dokumentet e Financimit.

NENI 9 - MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E PËRGJITHSHME

9.1. Monitorimi

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë që në periudha kohore prej 6 muajsh, gjatë Periudhës së Konçesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë Projektin për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues mund të monitorojë Projektin në çdo kohë në rast se ka

informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve të kësaj Kontrate nga ana e Konçesionarit.

9.2. Mbikëqyrja e përgjithshme e punimeve

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të ushtrojë mbikëqyrje të përgjithshme me afate tre mujore, gjatë Fazës së Ndërtimit dhe vënies në punë të Projektit me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti i tyre, të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të Projektit.

Në rast të shkeljeve të Kontratës, të konstatuara gjatë monitorimit dhe mbikëqyrjes së përgjithshme, Konçesionari do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

NENI 10 - DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

- 10.1. Të miratojë Projektin e Zbatimit të hidrocentralit, të përgatitur nga vetë Konçesionari, në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në procedurën e garës, brenda 2 muajve nga data e dorëzimit të projektit.
- 10.2. Të ndihmojë Konçesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e Kontratave/Kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të Objektivit të kësaj Kontrate.
- 10.3. Të garantojë Konçesionarin që ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen e Projektit të Konçesionarit.
- 10.4. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për detyrimet ligjore dhe kontraktore në rast të mos përmbushjes së këtyre detyrimeve nga ana e tij duke shpërblyer të gjitha dëmet e shkaktuara Konçesionarit për shkak të shkeljes së Kushteve të përcaktuara në kontratën e koncesionit.
- 10.5. Të sigurojë vazhdimësinë e kësaj kontrate pavarësisht ndryshimeve të subjekteve apo objektivave të Sektorit Elektro- energjitik Shqiptar.
- 10.6. Nëse ndërtimi pezullohet për ndonjë arsye sigurie, Autoriteti Kontraktues do të zgjasë Periudhën Koncesionare për periudhën përkatëse të pezullimit me kusht që Konçesionari, brenda një afati të arsyeshëm por jo me shume se 30 dite nga përfundimi i situatës së konfliktit dhe/ose protestës, duhet të paraqesë prova të mjaftueshme që provojnë këto situata. Periudha koncesionare nuk do të zgjatet nëse pezullimi është kryer si pasojë e pasigurisë së krijuar nga Konçesionari
- 10.7. Numri maksimal i personelit të huaj të punësuar nga Konçesionari nuk mund të

tejkalojë 10 % të numrit të përgjithshëm të personelit.

KREU III

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT

NENI 11 - DETYRIMET E KONCESIONARIT

11.1. Përgjegjësia e Konçesionarit

Ortakët e Shoqërisë Konçesionare dhe Shoqëria Konçesionare janë solidarisht përgjegjës ndaj Autoritetit Kontraktues për përmbushjen e detyrimeve që i janë atribuar Konçesionarit sipas kësaj kontrate. Përmbushja e rregullt dhe e plotë, nga ana e ndonjërës prej shoqërive të Bashkimit të përkohshëm, i ndonjë detyrimi, konsiderohet si një përmbushje e plotë e këtij detyrimi nga Konçesionari.

11.2. Referenca të tjera

Çdo referencë për "Konçesionari" në këtë Kontratë do të konsiderohet se i referohet Subjektit për Qëllime të Veçanta, shoqërisë "KOVLU ENERGJI" sh.p.k. si dhe secilit dhe të gjitha shoqërive pjesëmarrëse (ortakëve) në këtë shoqëri, përveç kur konteksti në mënyrë të qartë sugjeron, se një referencë e tillë do të bëhet ndaj një ose dy shoqërive, në vend të të gjithave.

11.3. Shërbimet

Konçesionari, duhet të marrë masa për trajtimin e ujërave të zeza dhe furnizimin me energji elektrike dhe të marrë përsipër kostot, shpenzimet dhe detyrimet në lidhje me këtë.

11.4. Garancitë

11.4.1. Konçesionari zbaton çdo procedurë të nevojshme për rikthimin e të drejtave të konçesionit mbi impiantet.

11.4.2. Nëse konçesionari dështon në marrjen, ruajtjen apo rinovimin e çdo sigurimi mbulues siç parashikohet, Autoriteti Kontraktues mund të kontaktojë sigurim mbulues me shpenzime të konçesionarit, pas një njoftimi paraprak me shkrim 14 ditë përpara, për Konçesionarin, ku njoftohet vullneti për një veprim të tillë.

11.5. Zbatimi i Projektit dhe Objekti Kontratës

Konçesionari është i detyruar të zbatojë Projektin dhe Objektin e Kontratës në përputhje me termat dhe kushtet e saj.

Nëse studimi gjeologjik (pjesë e projektit të zbatimit) kushtëzon vazhdimësinë e kontratës konçesionare, konçesionari merr përsipër çdo pasoje deri në zgjidhjen e Kontratës



Konçesionare dhe nuk ka të drejtë të kërkojë ndonjë dëmshpërblim, apo te ngrejë pretendime ndaj Autoritetit Kontraktues. Në këtë rast Konçesionari përjashtohet nga detyrimi i mbajtjes së garancisë së kontratës.

11.6. Veçanërisht Konçesionari duhet që:

- 11.6.1. Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues, projektin e zbatimit, brenda 18 muajve nga Hyrja ne Fuqi e Kontratës.
- 11.6.2. Të marrë të gjitha Autorizimet e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.
- 11.6.3. Të zbatojë planin e investimit e paraqitur sipas Aneksit B bashkëlidhur kontratës;
- 11.6.4. Të marrë masa që çdo Investim të bëhet sipas afateve të përcaktuar dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;
- 11.6.5. Të zbatojë Projektin për ndërtimin e Hidrocentralit Poçem, me fuqi totale të instaluar në sasinë jo më pak se 99,500 kW. Nëse gjatë zbatimit të projektit do të rezultojnë shkaqe teknike te bazuara, që nuk varen nga Konçesionari , të cilat kushtëzojnë uljen e kapacitetit të fuqisë së instaluar, me miratim te Autoriteti Kontraktues, mund te lejohet ulja e fuqisë së instaluar, por jo me shumë se 20%.
 - 11.6.5.1. Arsyeja e uljes së fuqisë së instaluar duhet të shpjegohet dhe provohet teknikisht nga Konçesionari, dhe të miratohet nga Autoriteti Kontraktues. Arsyet e uljes së fuqisë së instaluar mund te jene nga:
 - a) identifikimi i një rreziku të lartë për filtrimin apo kullimin, dhe për këtë kërkohej një ndryshim (lidhur vendndodhjen e trupit të digës, kushtet e ujëmbledhësit, etj):
 - b) kushtet gjeologjike /gjeoteknike/sizmike. Nëse nga anketat edhe studimet e hollësishme identifikohet një rrezik i lartë lidhur me stabilitetin e pjerrësisë apo kapacitetit mbajtëse të digës, etj, dhe një ndryshim (lidhur vendndodhjen e trupit të digës, tipit të trupit të digës, kushtet e ujëmbledhësit etj.) është i domosdoshëm:
 - c) paraqitja e rreziqeve teknike dhe/ose pamundësisë të aplikimit në ujëmbledhës dhe/ose në fund të kanalit të ujit që mund të rezultojë në kërkesën për uljen e kapacitetit të instaluar:
 - d) Nëse ka një ndryshim të konsiderueshëm të prurjeve në rrjedhën e lumit (normat e shkarkimit) dhe / ose identifikohen reshje shiu, dhe vlerat optimale në basen rezultojnë të ndryshueshme:
 - e) ndryshimet drastike në çmimet e energjisë elektrike në lidhje me çmimin e shitjes të konsideruar në Ofertë, dhe kjo shkakton ndryshime të konsiderueshme (më shumë se 15%) të vlerës IRR, kapaciteti optimal i instaluar mund të rivlerësohet si pasojë e rishikimit të llogaritjeve teknike:
 - 11.6.5.2. Në rast të një ndryshimi të fuqisë e instaluar deri në 20% për arsye të detyruar të të dhënave teknike, nuk do të aplikohet asnjë penalitet ndaj Konçesionarit;

Konçesionari do të jetë përgjegjës për prodhimin e shumës vjetore të energjisë elektrike sipas Projektit të zbatimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktues.

- 11.6.5.3.** Asnjë shkak teknik nuk justifikon uljen e kapacitetit të instaluar, në më shumë se 20%, dhe një shkelje e tillë do të jetë arsye për të zgjidhur kontratën nga ana e Autoritetit Kontraktues.
- 11.6.6.** Të administrojë projektin gjatë Periudhës së Konçesionit;
- 11.6.7.** Të kërkojë nëse e gjen me interes dhe të përshtatshme, zbatimin e detyrimit të Autoritetit Kontraktues sipas nenit 10, më sipër.
- 11.6.8.** Të parandalojë dhe të kontrollojë çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë punim i tij dhe të kthejë ambientin, me shpenzimet e veta, në situatën e mëparshme (para ndotjes).
- 11.6.9.** Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta.
- 11.6.10.** Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e Projektit;
- 11.6.11.** Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.
- 11.6.12.** Konçesionari nuk duhet të ndërhyjë në burimet ujore që furnizojnë ujësjellësin e zonës;
- 11.6.13.** Konçesionari duhet të marrë masa për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i legjisllacionit në fuqi për ruajtjen e ekosistemit natyror, si dhe të sasisë së ujit ekologjik në shtratin parësor të burimit ujor (lumit/përroit) në përputhje me rregullat ligjore në fuqi;
- 11.6.14.** Konçesionari duhet të sigurojë ujin e mëvonshëm për vaditje, në përputhje me nevojat e bujqësisë dhe legjisllacionit në fuqi për rezervat ujore.
- 11.6.15.** Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjisllacionin shqiptar në fuqi;
- 11.6.16.** Konçesionari ka të drejtë, kundrejt zgjedhjes së tij për shitjen e energjisë që i përket

pjesës së tij të energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentrali, po ashtu me qëllim marrjen e certifikatave të gjelbra (CER) apo ndonjë nxitje tjetër ekuivalente, qe ka të bëjë me prodhimet e energjive të rinovueshme, duke patur parasysh parashikimet e kësaj Kontrate.

11.6.17. Gjatë fazës së Ndërtimit, bazuar në ligjin nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, Konçesionari është i detyruar të emërojë një subjekt në rolin e mbikëqyrësit të punimeve. Ai mund të jetë person fizik, juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

11.6.18. Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.

NENI 12 - NDËRTIMI I IMPIANTIT

12.1. Projektimi

Projekti i detajuar përgatitet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Aneksin A në mënyrë që çdo impiant të ndërtohet në përputhje me Kërkesat Minimale Teknike

12.2. Ndërtimi

- 12.2.1. Konçesionari ndërton impiantet sipas projektit të detajuar dhe në përputhje me praktikatat e mira Industriale në lidhje me impiante të tilla.
- 12.2.2. Konçesionari do të fillojë ndërtimin në Datën e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit dhe do ta përfundojë në përputhje me praktikatat e mira Industriale si dhe sipas aneksit bashkëlidhur, projekti i zbatimit të miratuar nga AK.
- 12.2.3. Nën veprat e objektit do të ndërtohen brenda afatit të përcaktuar nga palët.
- 12.2.4. Përveç kur në këtë Kontratë parashikohen shkaqe të arsyeshme, nëse konçesionari dështon përfundimin e fazave të ndërtimit në kohën e caktuar, përveç se kur shkaqet që shkaktojnë vonesën nuk janë në kontrollin e tij, konçesionari është i detyruar të paguajë dëmet për çdo ditë vonese.
- 12.2.5. Konçesionari i paguan dëmet sipas muajve kalendarike brenda 1 muaji nga fillimi i muajit pasardhës. Në rast se konçesionari nuk paguan dëmet brenda 3 muajve nga data e caktuar, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të tërheqë garancinë e kontratës. Konçesionari është përgjegjës për ndërtimin e të gjitha rrugëve të nevojshme hyrëse, nga rrjeti ekzistues rrugor shqiptar në Shesh, të parashikuara në kontratë. Konçesionari do të negociojë me mirëbesim me autoritetet lokale për ndarjen e shpenzimeve kur

infrastruktura që të ndërtohet paraqet interes edhe për njësinë e pushtetit vendor. Nëse organet e pushtetit vendor nuk bien dakord, përgjegjësia dhe kostot e ndërtimit të rrugëve hyrëse është e Konçesionarit.

12.3. Rrethana të veçanta gjatë fazës së ndërtimit: Zgjatja e afatit të përfundimit të punimeve

12.3.1. Data e Planifikuar e Përfundimit të Ndërtimit për secilën impiant zgjatet si më poshtë:

- (a) nëse ka ndodhur një ngjarje e Forcës Madhore, data e caktuar e përfundimit të punimeve zgjatet për një periudhë kohore të barabartë me vonesën e shkaktuar nga Forca Madhore;
- (b) në qoftë se Qeveria nxjerr akte ose kryen veprime të cilat ndikojnë në shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, atëherë data e parashikuar për përfundimin e punimeve zgjatet për një periudhë kohore të barabartë me vonesën e shkaktuar nga veprime ose akte të tilla.
- (c) nëse ka ndodhur një ngjarje tjetër e parashikuar shprehimisht në këtë Kontratë, data e caktuar e përfundimit të punimeve zgjatet për një periudhë kohore të barabartë me vonesën e shkaktuar nga ngjarja.
- (d) nëse një ngjarje e shkaktuar nga rrethana që nuk janë për faj të Konçesionarit, data e caktuar e përfundimit të punimeve zgjatet për një periudhë kohore të barabartë me vonesën e shkaktuar nga ngjarja.
- (e) në qoftë se, relike arkeologjike, kulturore, fosile, varreza dhe përkujtimore, mbetje artistike apo objekte të tjera, ose sende të tjera me rëndësi arkeologjike, gjeologjike ose historike, janë zbuluar në, ose rreth Sheshit, dhe këto zbulimeve shkaktojnë vonesa në përfundimin e punimeve, data e parashikuar për përfundim e punimeve do të zgjatet për një periudhë kohore të barabartë me kohëzgjatjen e vonesës për këto shkaqe.
- (f) Çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë nen zgjidhet sipas mekanizmave të parashikuara në këtë Kontratë. Në rast se ndodh ndonjë nga ngjarjet e lartpërmendura, konçesionari përfiton shtyrje të afatit por nuk ka të drejtë të kompensohet për dëmet përveç se kur parashikohet shprehimisht ndryshe, në këtë Kontratë.
- (g) Përtej kontrollit apo gabimit të Konçesionarit, në qoftë se një vonesë e caktuar lidhur me lejet, procedurat e shpronësimit, proceset ligjore (gjykatat, pezullimit, etj), apo për arsye teknike (të tilla si ekzistenca e një anomalie gjeoteknike ose hidrogeologjike, pamundësia për zgjidhjen e një problemi gjeologjik në kohëzgjatje e përcaktuar më parë, etj), Autoriteti Kontraktues vlerëson dhe pranon kërkesën e Konçesionarit për zgjatjen e afatit, kur e gjen atë të provuar dhe në përputhje me shkaku që ka shkaktuar vonesën.
- (h) Në rastin e konstatimit të rasteve që përbëjnë shkaqe për shtyrjen e afatit,

Konçesionari brenda një periudhe të arsyeshme por jo më vonë se 30 ditë nga dita e fundit e përfundimit të shkakut pengues, duhet të njoftojë zyrtarisht Autoritetin Kontraktues dhe t'i paraqesë kërkesën dhe dokumentacionin përkatës që provon shkakun. Në çdo rast shtyrja e afatit duhet të materializohet me nënshkrimin nga palët të shtesës së kontratës.

12.3.2. Monitorimi dhe Inspektimi i Ndërtimit të impianteve

Përveç monitorimit dhe inspektimit nga Entitetet përkatëse Shtetërore në përputhje me Ligjin Shqiptar, Autoriteti Kontraktues mund ta monitorojë dhe inspektojë ndërtimin gjatë Fazës së Ndërtimit në prani të Konçesionarit, pasi i jep një njoftim të mëparshëm të Konçesionarit; me kusht që, gjithsesi, ky monitorim dhe inspektim të mos shkaktojë ndonjë pengesë të paarsyeshme, të ndërhyje në progresin e ndërtimit ose të ndërpresë ndërtimin padrejtësisht. Rezultatet e monitorimit dhe inspektimit do të përmbliohen me shkrim dhe nënshkruhen menjëherë më pas nga të dyja Palët. Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër kostot e monitorimit dhe inspektimit të ndërtimit të Hidrocentralit nga Autoriteti Kontraktues, përveç kur monitorimi dhe inspektimi nxjerr të meta thelbësore në ndërtim, materiale, pajisje ose makineri, rast në të cilin kostot i merr përsipër Konçesionari.

12.3.3. Konçesionari i raporton Autoritetit Kontraktues çdo 3 muaj:

- (a) përparimin e punimeve dhe masat e marra për eliminimin e vonesave
- (b) defekte të rëndësishme;
- (c) zbatimin e kontrollit të cilësisë dhe të sistemeve të sigurimit;
- (d) të dhëna mbi shëndetin e punonjësve dhe aksidentet eventuale në punë;
- (e) pretendimet e palëve të treta;
- (f) ngjarje apo rrethana për të cilat Autoriteti Kontraktues është ose mund të jetë përgjegjës sipas kësaj Kontrate.

12.3.4. Çdo organ shtetëror i përballon vetë shpenzimet e monitorimit dhe inspektimit të ndërtimit të impianteve.

12.3.5. Detyrat e tjera

Konçesionari duhet :

- (a) të vërë në dispozicion kopje të çdo skice dhe dokument projektimi nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues apo përfaqësuesi i tij;
- (b) ti sigurojë projektet dhe dokumentet e tjera Autoritetit Kontraktues në përputhje me këtë Kontratë;
- (c) parandalojë dhe kontrollojë ndotjen e ambientit që mund të shkaktohet nga kryerja e

- punimeve;
- (d) të marrë të gjitha masat mbrojtëse të nevojshme në lidhje me Sheshet dhe impiantet
 - (e) të trajtojë mbeturinat ndërtimore dhe mbeturinat e projektit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Praktika e mira Industriale;
 - (f) të respektojë të drejtat ekzistuese të palëve të treta për nxjerrjen e ujit për ujitje, nëse këto të drejta janë të regjistruara në regjistrin e lejeve për shfrytëzimin e ujit.
 - (g) të mos shkaktojë dëmtime të tubacioneve ekzistuese në Sheshe, kablllove apo përçuesve në Sheshe, ekzistenca e të cilave ka qenë e njoftuar nga Autoriteti Kontraktues, përveç se me miratim të Autoritetit Kontraktues.

NENI 13 - VLERËSIMI I INVESTIMEVE

- 13.1.** Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet duke përfshirë edhe fondin rezerve në masën 5%, janë në vlerën totale prej 14,841,460,319 (katërbëdhjetë miliard e tetëqindedyzetënjë milion e katërqindëgjashtëdhjetë mijë e treqindenëntëmbëdhjetë) Lekë (pa TVSH) nga të cilat 5,455,000,000 (pesë miliard e katërqindëpesëdhjetëpesë milion)Leke, do të investohen në makineri e pajisje mekanike dhe elektrike, sipas Aneksit B
- 13.2.** Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me kontratë ndërmjet palëve:
- (a) pas variantit përfundimtar të Projekt- zbatimit i cili mund të përmirësohet por duke ruajtur të pandryshuar kuotat/termat e përcaktuara në këtë Kontratë;
 - (b) në çdo kohë gjatë zbatimit të Projektit në ndërtimin e veprës.

Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 14,841,460,319 (katërbëdhjetë miliard e tetëqindedyzetënjë milion e katërqindëgjashtëdhjetë mijë e treqindenëntëmbëdhjetë) Lekë, por jo më e vogël se 13,357,314,287 (trembëdhjetë miliard e treqindëpesëdhjetëshatë milion e treqindëkatërbëdhjetë mijë e dyqindëtetëdhjetëshatë) lekë, që përfaqëson një ndryshim të investimit në vlerën 10% (dhjetë përqind) të investimit total të parashikuar.

NENI 14 - PROGRAMI I PUNIMEVE

- 14.1.** Konçesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve:

- 14.1.1.** Konçesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit të ndërtimit sipas Aneksit C nga data e lëshimit të lejes së ndërtimit.

- 14.1.2. Konçesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga data e marrjes së lejeve. Përveç rasteve që kanë lidhje me gabimet/përgjegjësitë e Konçesionarit, afati për pajisjen me lejet e nevojshme është jo më shumë se 24 muaj nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës së Konçesionit. Afati i ndërtimit është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në Aneksin C.
- 14.1.3. Këto afate mund të ndryshohen me kontratë midis Autoritetit Kontraktues dhe konçesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedural për marrjen e tyre. Koha e shtyrjes do të jetë sa koha e vonesave të krijuara nga subjektet shtetërore.

NENI 15 - TESTIMI I VEPRËS

15.1. Testi i vënies në punë (performancës)

- 15.1.1. Konçesionari njofton me shkrim Autoritetin Kontraktues të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara, për datën dhe orën në të cilën do fillojë testi i vënies në funksionimin të impiantit.
- 15.1.2. Nëse Autoriteti Kontraktues ose personeli i emëruar prej tij, nuk janë të pranishëm në kohën e caktuar, Testi i Performancës mund të kryhet në mungesë të tyre dhe për rezultatet dërgohet njoftim me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga testimi dhe vënia në punë.

15.2. Raportimi përfundimtar dhe Certifikata përfundimtare

- a) Brenda 1 muaji nga përfundimi i çdo testi Performance, Konçesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktues një "**Raport Përfundimi**".
- b) Nëse ndërkohë nuk është lëshuar asnjë Njoftim Mos përmbushjeje, Autoriteti Kontraktues lëshon një Certifikatë Finale Përfundimi jo më vonë se 1 muaj pas dorëzimit të raportit përfundimtar. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk lëshon një Certifikatë Finale Përfundimi dhe nuk arrin të lëshojë as edhe një Njoftim Mos përmbushjeje, në secilin rast brenda 1 muaj nga dorëzimi i raportit përfundimtar, Certifikata Finale e Përfundimit konsiderohet e lëshuar për impiantin respektiv.

15.3. Lëshimi i njoftimit të Mos përmbushjes

- a) Nëse Autoriteti Kontraktues konstaton se ndonjë raport përfundimi tregon se projekti nuk është në përputhje me projektin e detajuar, Autoriteti Kontraktues mund të lëshojë një Njoftim Mos përmbushjeje jo më vonë se 1 muaj pas dorëzimit të raportit të përfundimit, duke deklaruar se projekti nuk përputhet me projektin e detajuar si dhe të tregojë kriteret e vençat të projektimit të detajuar me të cilat projekti nuk përputhet. Konçesionari duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues brenda 1 muaji nga marrja e këtij Njoftimi nëse ajo pajtohet apo ka

kundërshtime me këtë Njoftim Vërejtjeje dhe, nëse Konçesionari nuk është dakord me një njoftim të tillë, të paraqesë arsyet përkatëse. Secila Palë mund t'i referohet për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, mekanizmit për zgjidhjen e konflikteve të parashikuar nga kjo kontratë.

- b) Pas pranimit të Njoftimit të Mos përmbushjes, Konçesionari, brenda një kohe të arsyeshme por jo më vonë se 60 ditë, merr të gjitha masat e nevojshme korrigjuese për të përmirësuar shkaqet e mospajtit të përmendura në njoftimin e dështimit. Përveç se kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, konçesionari do të përballojë kostot dhe shpenzimet e secilit veprim korrektues të ndërmarrë. Kur veprimet korrigjuese kanë përfunduar, Konçesionari planifikon provë tjetër të vënies në punë.

15.4. Detyrimet pas përfundimit

Jo më shumë se 1 muaj pas Datës së Përfundimit të Punimeve, Konçesionari duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues:

- a) Dy kopje me të gjitha të dhënave teknike (përfshirë edhe raportin e projektimit, llogaritjen dhe dokumentet e projektimit, si në letër ashtu edhe në formë elektronike, duke përfshirë të gjitha udhëzimet e përshtatshme) në lidhje me projektimin dhe ndërtimin e impianteve;
- b) Dy kopje të skicave të impianteve ("siç janë ndërtuar"), së bashku me të dhënat që lidhen me secilën provë për vënien në punë dhe Certifikatat Përfundimtare, dhe
- c) Dy kopje të çdo dokumenti tjetër teknik ose material të tjera në lidhje me impiantet siç mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.

15.5. Braktisja

Ndërtimi i impiantit do të konsiderohet i braktisur nga Konçesionari nëse, pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues, konçesionari:

- (a) Njofton Autoritetin Kontraktues rreth vendimit të tij të braktisjes të të gjitha ose një pjesë të Punimeve në lidhje me atë impiant;
- (b) Nuk rifillon, në tërësi ose pjesërisht, punimet në lidhje me atë impiant brenda 6 muajve nga përfundimi i një ngjarjeje të Forcës Madhore;
- (c) pa asnjë leje apo një gabim të konçesionarit, në qoftë se ndërtimi i të gjitha punëve në lidhje me impiantin ndalon apo pezullohet për një periudhë prej gjashtë muajsh;
- (d) tërheq nga Sheshi duke njoftuar ose jo Autoritetin Kontraktues, drejtpërsëdrejti

ose nëpërmjet veprimeve të ndërmarra nga ndonjë Kontraktues për ndërtimin , të gjithë apo pjesën më të madhe të personelit, para datës së parashikuar për përfundimin e punimeve:

- (i) një tërheqje e tillë çon në ndalimin e plotë të punimeve;
- (ii) nuk caktohet një Kontraktues zëvendësues për të vazhduar ndërtimin brenda 6 muajve nga data që është ndalur ndërtimi, dhe
- (iii) një ndalim i tillë, sipas gjykimit të arsyeshëm, nuk është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e personelit.

Data e braktisjen do të konsiderohet: në lidhje me pikën (a) si më sipër, data në të cilën është marrë njoftimi; ndërsa për pikat e mbetura (b,c,d) më sipër, data në të cilën përfundojnë 6 muajt e përmendura.

Nuk konsiderohet braktisje :

- (a) ndodhja e braktisjes për arsye të forcës madhore.
- (b) braktisja për shkak të dështimit për të arritur mbylljen financiare për Projektin.

NENI 16 - FUNKSIONIMI DHE MIRËMBAJTJA

16.1. Vënia në punë

Pas përfundimit paraprak të një impianti dhe fillimit të Fazës së Operimit, konçesionari ka të drejtë të :

- (a) të ushtrojë të gjitha të drejtat e Koncesioneve, në përputhje me Praktikat e mira Industriale dhe të përmbushë kërkesat teknike minimale;
- (b) të verë në funksion dhe të mirëmbajë impiantet si operator i arsyeshëm dhe i kujdesshëm;
- (c) të përcaktojë dhe zbatojë një regjim të planifikuar të mirëmbajtjes në përputhje me Praktikat e mira Industriale
- (d) Raportojë në mënyrë të kënaqshme tek Autoriteti Kontraktues.

Për të shmangur çdo dyshim, konçesionari ka të drejtë të verë në funksion veçmas secilin impiant pavarësisht përfundimit të impianteve të tjera.

16.2. Raportimi

Konçisionari është i detyruar që çdo 3 muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

NENI 17 - ZGJIDHJA E KONTRATËS SË KONCESIONIT

17.1. Zgjidhja e parakohshme e Kontratës.

17.1.1. Konçisionari ka të drejtë të përfundojë këtë Kontratë :

- (a) kur ka rritje të kostos, siç përcaktohet nga kjo Kontratë ;ose
- (b) kur ndodh ndonjë ngjarje tjetër, pasojat e të cilës në thelb dëmtojnë ekonominë e projektit; në një rast të tillë Konçisionari i ofron Autoritetit Kontraktues fakte dhe arsye që motivojnë zgjidhjen. Autoriteti Kontraktues pasi të konfirmojë ngjarjet, pasojat e të cilës kanë sjellë dëmtimin e ekonomisë së projektit atëherë Konçisionari mund të vijoje me përfundimin e kontratës koncesionare, ose
- (c) pa ndonjë arsye të specifikuar në këtë Kontratë, gjatë fazës së para-ndërtimit. Në këtë rast shumat e përfituara nga sigurimi kontratës i ngelen Autoritetit Kontraktues si shpërblim për dëmin e shkaktuar.
- (d) Për shkak të të ndryshimit të legjislacionit në Shqipëri, të cilat ndodhin pas datës së hyrjes në Fuqi të kësaj kontrate dhe krijojnë kosto shtese te konsiderueshme qe tejkalojnë vlerën 30% te projektit, të cilat përkeqësojnë, dëmtojnë apo kane efekt tjetër negativ mbi interesat financiare të Konçisionarit, pa paguar ndonjë kusht penal apo dëmshpërblim.
- (e) Nëse zona ku parashikohet te zhvillohet projekti, për shkaqe të formacioneve ekzistuese gjeologo – inxhinjrike, sizmike etj, mund të jetë subjekt i anomalive hidrogjeologjike, si dukuri serioze karstike: a) filtrim të mëdha; b) problemet e humbjes së ujit, etj. dhe në qoftë se pamundësia e gjenerimit të një ujëmbledhësi të tillë dhe/ose rreziqe të larta të humbjeve të ujit, konfirmohen pas sondazheve, analizave dhe studimeve te thelluara, gjeologjike/gjeoteknike ato i paraqiten Autoritetit Kontraktues, me qellim argumentimin e pamundësisë se realizimit te projektit, dhe me miratimin nga ky i fundit. Nëse një situatë e tillë mund te sjelle pamundësinë teknike të realizimit të Projektit ose në rast të ekzistencës së rrethanave të një rreziku jashtëzakonisht të lartë për ndërtimin/realizimin e

projektit ose zgjidhjet e mundshme për një problem të tillë gjeologjik i tejkalojnë mundësitë e Konçesionarit për një Projekt fitimprurës pa ndonjë gabim/dështim të Konçesionarit, konçesionari ka të drejtë të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme, duke mos qenë subjekt i penaliteteve, mbajtjes së garancisë apo sanksioneve të tjera financiare, nga Autoriteti Kontraktues.

- (f) Nëse Autoriteti përkatës për lëshimin e lejeve/dëshmime mjedisore, refuzon të miratojë Lejen Mjedisore për ndonjë shkak ambientar të ndodhur gjatë fazës para ndërtimore, i cili nuk është marrë në konsiderate, Konçesionari ka të drejtë të ndërpresë në mënyrë të njëanshme kontratën, pa qenë subjekt i aplikimit të penaliteteve dhe nuk është i legjitimuar të adresojë asnjë pretendim ndaj Autoritetit Kontraktues dhe/ose organeve të tjera shtetërore.

17.2. Mos përmbushjet nga Konçesionari.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përfundojë këtë Kontratë për mos përmbushje të detyrimeve nga ana e Konçesionarit, duke e njoftuar këtë të fundit me shkrim kur:

- a) Kur konçesionari nuk fillon punën për 10 muaj (për shkak të tij) nga data e marrjes së lejeve. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e sigurimit të kontratës të parashikuar në nenin 19;
- b) Konçesionari ndodhet në kushtet e Nenit 15.5 Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë sigurimin e kontratës të parashikuar në nenin 19 si dhe hidrocentralin siç është në momentin e braktisjes;
- c) Kur Shoqëria Koncesionare është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi, për faj të konçesionarit. Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e sigurimit të kontratës.
- d) Konçesionari kryen shkelje apo nuk përmbush detyrime, sipas kësaj Kontrate dhe këto shkelje kanë vazhduar për më tepër se 3 muaj pas njoftimit për shkelje nga Autoriteti Kontraktues.
- e) Konçesionari nuk arrin të sigurojë financimin brenda 18 muajsh nga data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës së koncesionit.
- f) Në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 20% të asaj të propozuar sipas projektit të propozuar nga konçesionari.
- g) Në rast të kryerjes së më shumë se dy shkeljeve të detyrimeve të kontratës nga ana e Konçesionarit.

Këto dispozita të këtij neni nuk zbatohen kur rastet e mësipërme janë shkaktuar nga një Veprim Shtetëror në kundërshtim me Kontratën, nga mos përmbushje e detyrimeve nga ana e Autoritetit Kontraktues apo nga ngjarje të Forcës Madhore. Afatet e mësipërme janë objekt shqyrtimi dhe/ose ndryshimi sipas parashikimeve të kësaj Kontrate Koncesioni.

17.3. Mos përmbushje nga Autoriteti Kontraktues

Konçesionari ka të drejtë të përfundojë këtë Kontratë për mos përmbushje të detyrimeve nga ana e Autoritetit Kontraktues, duke e njoftuar këtë të fundit me shkrim nëse :

- a) Nëse organi shtetëror, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, shpronëson, konfiskon apo shtetëzon :
 - i. aksione në Shoqërinë Koncesionare ose ndonjë nga ortakët/aksionarët
 - ii. asete, materiale apo të drejta të Konçesionarit;
 - iii. çdo akt tjetër i ndonjë organi qeveritar që ndikon negativisht në :
 - gëzimin e të drejtave dhe përfitimeve të parashikuara nga kjo Kontratë, nga ana e Konçesionarit;
 - përmbushjen e detyrimeve të kësaj kontrate nga ana e Konçesionarit;
 - funksionimin dhe mirëmbajtjen e impianteve dhe prodhimin e energjisë elektrike, ose
 - gëzimin e të drejtave dhe përfitimeve nga ndonjë ortak/aksionar i Shoqërisë Koncesionare;
- b) Konçesionari nuk është në gjendje të përmbushë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate për shkak të një Veprimi Shtetëror në kundërshtim me Kontratën që ka vazhduar për më shumë se 6 muaj;
- c) Autoriteti Kontraktues nuk vë në dispozicion të Konçesionarit, sheshet siç përcaktohet në këtë Kontratë; ose
- d) Autoriteti Kontraktues, pas dorëzimit të kërkesës për shpronësim nga konçesionari nuk arrin të kryejë procedurat përkatëse në përputhje me ligjin, ose
- e) Autoriteti Kontraktues ose ndonjë organ tjetër shtetëror, pas dorëzimit nga konçesionari të dokumentacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi, nuk arrin t'i japë Konçesionarit të gjitha ose ndonjë nga Lejet, Licencat dhe/ose Autorizimet e nevojshme brenda afateve kohore, të përcaktuara në këtë kontratë; ose
- f) Autoriteti Kontraktues kryen shkelje të tjera apo nuk përmbush detyrime, sipas kësaj Kontrate dhe këto shkelje kanë vazhduar për më tepër se 3 muaj pas njoftimit për shkelje nga Konçesionari.

Nuk zbatohet ky nen kur rastet e mësipërme janë shkaktuar nga mos përmbushja e detyrimeve të Konçesionarit apo nga ngjarje të Forcës Madhore.

17.4. Forca Madhore e Tejzgjatur.

Secila pale ka të drejtë të përfundojë këtë Kontratë duke njoftuar me shkrim Palën tjetër, nëse asnjë nga Palët nuk është në gjendje të kryejë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, për shkak të një ngjarjeje të zgjatur Forcës Madhore, përveç rasteve kur pala që ka qenë në pamundësi të përmbushjes së detyrimeve për shkak të forcës madhore, është në proces të marrjes së masave dhe/ose riparimit të dëmeve të krijuara nga ngjarja e Forcës Madhore dhe ka njoftuar palën tjetër për vullnetin për vazhdimin e zbatimit të kontratës. Në çdo rast riparime të tilla do të mbulohen nga Konçesionari, pas pranimit nga ky i fundit në njoftim me shkrim për Autoritetin Kontraktues.

17.5. Njoftimet me shkrim të kryera nga Autoriteti Kontraktues, apo Konçesionari.

17.5.1. Në rast të vërtetimit të kushteve të zgjidhjes të parashikuara në Nenin 17, pika 17.2, pala që do të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën do të dërgojë një njoftim për fillimin e procedurave të zgjidhjes së kontratës. Kontrata do të konsiderohet e zgjidhur pas kalimit të 30 ditëve kalendrike, afat gjatë të cilit pala tjetër mund të paraqesë pretendime apo interpretim të ndryshëm të shkaqeve të zgjidhjes së kontratës. Për të shmangur cdo keqinterpretim, pas kalimit të afatit 30 ditor, pala që zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën, duhet të dërgojë njoftim përfundimtar për zgjidhjen e kontratës.

17.5.2 Në rast të vërtetimit të kushteve të zgjidhjes të parashikuara në Nenin 17, pika 17.2 dhe 17.3, pala që do të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratë do të dërgojë një njoftim për fillimin e procedurave të zgjidhjes së kontratës.

Kontrata do të zgjidhet pas kalimit të një periudhe kohore prej 90 ditësh kalendrike nga data e dërgimit të njoftimit të shkeljeve, me përjashtim të rasteve kur pala që ka shkaktuar mos përmbushjen para mbarimit të kësaj periudhe:

- i. eliminon mos përmbushjen, ose:
- ii. i paraqet palës tjetër një program masash korrigjuese brenda 1 muaji nga data e njoftimit, dhe e zbaton këtë program brenda afatit të përcaktuar nga NJZP.

Për të shmangur çdo keqinterpretim, pas kalimit të afatit 90 ditor, pala që zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën, duhet të dërgojë njoftim përfundimtar për zgjidhjen e kontratës

17.5.3. Në rast të vërtetimit të kushtit të zgjidhjes, të parashikuar në Nenin 17, pika 17.4, pala që do të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën do të dërgojë një njoftim për zgjidhjen e kontratës. Kontrata do të konsiderohet e zgjidhur menjëherë, përveç rasteve kur pala tjetër, brenda 10 ditëve kalendrike, njofton palën që njoftoi zgjidhjen e kontratës se është në proces të marrjes së masave dhe/ose riparimit të dëmeve të krijuara nga ngjarja e Forcës Madhore dhe ka shprehur vullnetin për vazhdimin e zbatimit të kontratës.

17.6. Detyrimet ne rast zgjidhje te Kontratës Koncesionare

- 17.6.1. Kur Konçesionari zgjidh këtë kontrate para fillimit të fazës së ndërtimit për mos përmbushje të detyrimeve nga Autoriteti Kontraktues, Autoriteti Kontraktues është i detyruar të paguajë për shpenzimet e Konçesionarit, për investimet e kryera deri në atë fazë dhe Konçesionari është i detyruar t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues të gjithë dokumentacionin e projektit, përfshirë studime, vëzhgime, etj.
- 17.6.2. Kur Autoriteti Kontraktues zgjidh këtë Kontrate për mos përmbushje nga Konçesionari sipas nenit 17.2. Konçesionari është i detyruar që të shpërblejë çdo dëm të shkaktuar ndaj Autoritetit Kontraktues ose palëve te treta.
- 17.6.3. Kur Konçesionari zgjidh këtë Kontratë për mos përmbushje të detyrimeve nga Autoriteti Kontraktues, në qoftë se zgjidhja ndodh pas fillimit të fazës së ndërtimit, por përpara Datës Aktuale të përfundimit të Punimeve, Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Konçesionarit, për transferimin e impianteve dhe të gjitha të drejtave që lidhen me to dhe të aseteve tek Autoriteti Kontraktues, në gjendjen "siç janë", në përputhje me këtë Kontratë, një vlerë të barabarte me shumën e (x) Kostos Aktuale te Investimeve, plus (y) Vlerën Neto Aktuale (NPV) (duke përdorur si normë skontimi të fluksit të të ardhurave 3 muaj EURIBOR + 50 bps, në kohën e zgjidhjes, nga dita e zgjidhjes deri në vitin e 35 të koncesionit), plus (z) çdo shpenzim tjetër që i shkaktohet Konçesionarit, si rezultat i përfundimit të kësaj Kontrate, përfshirë kostot për zgjidhjen e kontratave me punonjësit dhe shpenzimet që duhet t'u paguhen kontraktorëve, ose (ii) nëse zgjidhja ndodh pas Datës së Përfundimit të Punimeve, shuma e llogaritur (x) reduktohet 2,86% për çdo vit të plotë në të cilin ndodh zgjidhja e kontratës. Autoriteti Kontraktues në çdo rast është i detyruar të kthejë Sigurimin e Kontratës dhe/ose Sigurimin e Operimit sipas rastit.
- 17.6.4. Konçesionari do të marrë të gjitha masat për sigurimin e Projektit ndaj rreziqeve të shkaktuara duke përfshirë por jo limituar Zjarrin, tërmetin, përmytjen, në masën jo më pak se 100% të vlerës totale të investimeve.
- 17.6.5. Transferimet e impianteve, të drejtave dhe aseteve sipas neneve të mësipërm do të kryhet njëkohësisht me transferimin e pagesave përkatës, brenda 3 muajve nga zgjidhja e kësaj Kontrate.

Me zgjidhjen e kësaj kontrate sipas nenit të mësipërm, të drejtat, titujt dhe interesat e Konçesionarit transferohen te Autoriteti Kontraktues, çdo leje, licencë apo autorizim quhet i pavlefshëm dhe konçesionari është i detyruar të dorëzojë gjithë dokumentacionin që lidhet me projektin.

Asnjëra nga Palët nuk mund ta zgjidhë këtë kontratë përveç se ashtu siç parashikohet nga vetë

kjo e fundit.

17.7. Zgjidhja e kontratës nga secila palë

17.7.1. Secila nga Palët kanë të drejtë të zgjidhë Kontratën, pas njoftimit të Palës tjetër, kur:

- (a) Me gjithë plotësimin e kriterëve nga ana e Konçesionarit për aplikim për leje, licenca në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ndërhyrjen e Autoritetit Kontraktues, Konçesionari nuk është pajisur me to, për arsye ligjore që lidhen me fillimin e punimeve dhe/ose operimin e Impiantit. Në këtë rast Konçesionarit i rimbursohen shpenzimet e bëra deri në këtë fazë.
- (b) Përbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave të cilat nuk mund të kontrollohen nga asnjëra prej palëve.

17.8. Njoftimi i zgjidhjes së kontratës

Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate në përputhje me pikën e mësipërme, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër. Njoftimi duhet të përmbajë:

- (a) Detajet e duhura duke nënvizuar shkakun e zgjidhjes;
- (b) Datën e përfundimit të kontratës, në rast të mos korrigjimit të shkeljes brenda 6 muajve nga data e njoftimit.
- (c) Hollësitë e llogaritjes së pagesave si rezultat i zgjidhjes së kontratës;
- (d) Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

17.9. Zgjidhja e kontratës me konsensus

Palët kanë të drejtë ta zgjidhin Kontratën e Koncesionit me pëlqim të dyanshëm, duke negociuar mënyrën e kompensimit të investimit. Gjithsesi, Konçesionari ka gjithmonë të drejtë të përfitojë Sigurimin e Kontratës dhe/ose Sigurimin e Operimit, nëse ekziston.

17.10. Të drejtat e Palëve Financuese dhe zëvendësimi i Konçesionarit

17.10.1. Njoftimi i Palës Financuese për shkeljet

Menjëherë pas marrjes në dijen për shkelje serioze nga ana e Konçesionarit të detyrimeve kontraktore, që çënojnë zbatimin dhe operimin e Koncesionit ose sjellin si pasojë zgjidhjen e kontratës, Autoriteti Kontraktues përveç njoftimit të Konçesionarit, njofton edhe Palën Financuese me qëllim dhënien e një mundësie, kësaj të fundit, për të ndihmuar Konçesionarin për të korrigjuar ose marrë masa për të rregulluar këto shkelje brenda 3 muajsh nga data e një njoftimi të tillë. Autoriteti Kontraktues i jep Palës Financuese ndihmesë të arsyeshme për këtë qëllim.

17.10.2. Zëvendësimi i Konçesionarit

- (a) Në rast se nuk është bërë i mundur korrigjimi i shkeljes nga Konçesionari, Pala Financuese (nëse e gjykon me interes) zgjedh, të ndërhyje duke i propozuar

Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga marrja njoftimit transferimin e Projektit në duart e një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues i cili duhet që të ketë, ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën të barasvlershme me atë të Konçesionarit në momentin e fitimit të garës;

(b) Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues nuk do të pengojë apo vonojë pa arsye, pëlqimin e tij dhe do të bëjë ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash në lidhje me Palët Kontraktuese.

(c) Zëvendësuesi, do të ketë të drejtën e menaxhimit/administrimit të projektit dhe do të realizojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Konçesionarit, por nuk do të ketë të drejtë të shesë, të transferojë, të vendosë barra siguroese mbi hidrocentralin. Nëse Pala Financuese vendos të mos ushtrojë të drejtat e parashikuara në këtë nen ose nëse edhe pas ushtrimit të këtyre të drejtave nuk arrihet në një zgjidhje të arsyeshme për vazhdimësinë e projektit, kontrata do të zgjidhet.

Palët të cilat zotërojnë të drejtat e Koncesionit mund t'ja transferojnë këto të drejta njëri-tjetrit me anë të një njoftimi drejtuar Autoritetit Kontraktues. Ndërsa transferimi i këtyre të drejtave tek një palë e tretë mund të realizohet vetëm me miratimin e Autoritetit Kontraktues.

NENI 18 - KONTRATAT ME PALËT E TRETA

18.1. Konçesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të Projektit dhe çdo lloj kontrate tjetër, me qëllim realizimin e Objektivit të Koncesionit, duke respektuar kufizimin e vendosur në nenin 22.2 të kësaj Kontrate Koncesioni. Në të gjitha kontratat, Konçesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate Koncesioni.

18.2. Konçesionari duhet të pajisë Autoritetin Kontraktues me informacionin e mëposhtëm për nën – kontraktuesin e propozuar:

- Emrin e tij dhe adresën ;
- Qëllimet për të cilat nën- kontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar; dhe
- Vlerën e nënkontratës
- Çdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.
- Konçesionari është përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktues, për përmbushjen e detyrimeve nga ana e nënkontraktuesit.
- Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve,

* furnizuesve dhe të tretëve, në rast të moskuptimeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Konçesionarit.

NENI 19 - SIGURIMI I KONTRATËS

- 19.1. Konçesionari, para nënshkrimit të kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 706.736.206 ALL (Leke) (shtatëqindëgjashtë milion e shtatëqindetridhjetëgjashtë mijë e dyqindëgjashtë lekë) që përbën 5% të vlerës totale të investimit. Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkëlidhet kësaj Kontrate.
- 19.2. Sigurimi i Kontratës duhet të jetë i vlefshëm që nga data e lëshimit deri në periudhën që përfshin 90 ditë pas Datës së Përfundimit të Punimeve.
- 19.3. Sigurimi i Kontratës do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, të detyrimeve të Konçesionarit në lidhje me përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe përfundimin e testimit. Me përfundimin e sigurimit të Kontratës, Konçesionari duhet të dorëzojë formularin e Sigurimit të Operimit në masën 1% të vlerës së investimit. Sigurimi i Operimit do të jetë i vlefshëm deri në përfundim të periudhës së koncesionit.
- 19.4. Sigurimi i Kontratës do të shërbejë për pagesën e dëmeve të shkaktuara ndaj të tretëve, sipas përcaktimit të pikës 17.6.2 në masën e vlerësuar të tij.

NENI 20 - SIGURIMET

- 20.1. Konçesionari në çdo kohë do të pajiset, mbajë dhe ripërtërijë ato garanci sigurimi të kërkuara në lidhje me ushtrimin e të Drejtave Koncesionare, dhe do t'i përcjellë, ose do të kujdeset që t'i përcillen Autoritetit Kontraktues kopjet e certifikuara të çdo certifikatë sigurimi pas marrjes së një njoftimi paraprak prej Autoritetit Kontraktues.
- 20.2. Konçesionari duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të Impianteve dhe më pas Projektin e plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të paktën nga rreziqet e parashikuara sipas Ligjit 52/2014 dt. 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit" gjatë gjithë Periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit, brenda një afati 15 ditor nga data e sigurimit.
- 20.3. Në rast të dëmtimeve në Fazën e Ndërtimit, apo gjatë Fazës së Operimit vlera e dëmit e

- * kompensuar nga siguruesi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer Projektin në gjendjen që ishte para dëmtimit. Pjesa e zbritshme nga shuma që siguruesi do të paguajë për kompensimin e dëmit do të përballohet nga konçesionari.
- 20.4. Konçesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.
- 20.5. Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200,000 Euro për çdo ngjarje dhe 500,000 Euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1,000 Euro për çdo ngjarje dhe 2,000 Euro në vit.
- 20.6. Autoriteti Kontraktues do të shënohet si Palë bashkë – siguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

NENI 21 - VLERA E RI - INVESTIMIT

Duke filluar nga viti 25^{te} pas hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate Koncesioni, Konçesionari do të ri investojmë një minimum prej 60% të vlerës fillestare të investimeve për makineri dhe pajisje në përputhje me një plan të dakortësuar nga Palët për këtë qëllim. Kjo vlerë do të aktualizohet sipas indeksin e inflacionit.

NENI 22 - KUFIZIMET

- 22.1. Për çdo transferim të aksioneve/të kapitalit themeltar të saj tek të tretët Konçesionari duhet të marrë pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktues. Në këtë rast palës së tretë do ti transferohen dhe detyrimet apo të drejtat e përcaktuara në Kontratën e Koncesionit.
- 22.2. Konçesionari nuk ka të drejtë të nënkontrakttojë asnjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, për vlera më të mëdha se 50 % të vlerës së investimit, pa marrë miratimin paraprak, me shkrim, të Autoritetit Kontraktues. Për mënjanimin e ndonjë keqkuptimi furnizuesit e pajisjeve, materialeve dhe/ose dërgesave nuk do të konsiderohen nënkontraktorë sipas kësaj Kontrate. Nëse Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditëve nuk kthen përgjigje, kërkesa quhet e miratuar.
- 22.3. Konçesionari, pas miratimit nga Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që do të krijohen në zbatim të Projektit, si dhe të kësaj Kontrate Koncesioni, si dhe të lidhë çdo lloj kontrate financimi në çdo Huadhënës, me kusht që hipoteka, peng apo barra tjetër si dhe marrëveshja

- * përkatëse e financimit t'i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të Konçesionarit në këtë Kontratë.

NENI 23 - FORCA MADHORE DHE VEPRIMI SHTETËROR THELBËSISHT NË KUNDËRSHTIM ME KONTRATËN

23.1. Forca Madhore

23.1.1. Konsiderohen Ngjarje të Forcës Madhore

- Konçesionari nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likujdueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.
- Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Konçesionarit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Konçesionari duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep udhëzime të ndryshme, konçesionari duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

23.1.2. Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 1 muaji, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e përmbushjes së detyrimeve në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.

23.1.3. Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore.

23.1.4. Periudha e Koncesionit do të zgjatet me aq kohë sa ka vazhduar ngjarja e forcës madhore.

23.2. Veprimi Shtetëror në kundërshtim me Kontratën

23.2.1. Kur Konçesionari është penguar, pengohet ose vonohet në punën e tij të çdo ose për të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, ose në punën dhe mirëmbajtjen e secilit Impiant ose shitjes së sasisë Neto të Energjisë në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi, për shkak Veprimi Shtetëror në Kundërshtim me Kontratën, Konçesionari njofton Autoritetin Kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe

- bën të ditur për secilin Veprim Shtetëror në Kundërshtim me Kontratën ekzistencën dhe natyrën e Veprimit Shtetëror në Kundërshtim me Kontratën; Efektet e këtij veprimi mbi punën e Konçesionarit dhe të detyrimeve të tij të cilat do të pengohen ose vonohen, si rezultat i drejtpërdrejtë i Veprimit Shtetëror në Kundërshtim me Kontratën.
- Hapat që Konçesionari ka ndërmarrë ose synon për të marrë për të zbutur, për të shmangur, kapërcyer dhe /ose heqjen e pasojave që kanë efektet negative të këtij Veprimit Shtetëror në Kundërshtim me Kontratën në punën e Konçesionarit.
- 23.2.2.** Autoriteti Kontraktues, me marrjen e njoftimit, ka të drejtë të kërkojë që Konçesionari t'i dorëzojë informacione shtesë dhe dëshmi mbështetëse siç është e arsyeshme për të kërkuar mbështetje në përmbajtjen e Veprimit Shtetëror në Kundërshtim me Kontratën.
- 23.2.3.** Në qoftë se palët, nuk bien dakord në lidhje me ekzistencën ose efektet e Veprimit Shtetëror në Kundërshtim me Kontratën brenda 2 muaj pas përfundimit të afatit të parashikuar në Nenin 24.1 (Zgjidhja Miqësore) dhe Neni 24.2.1 secila pale ka të drejtë ta dërgojë çështjen në arbitrazh në përputhje me nenin 24.3.
- 23.2.4.** Nëse bien dakort ose përcaktohet se ka ndodhur Veprimi Shtetëror në Kundërshtim me Kontratën, Konçesionari ka të drejtë të dëmshpërblehet për dëmet e shkaktuara nëse :
- (a) Dëmet dhe vonesat janë rezultate direkte të Veprimit Shtetëror në Kundërshtim me Kontratën, dhe
 - (b) Pasojat nuk mund të ishin shmangur me gjithë kujdesin e treguar nga Konçesionari për evitimin e tyre.

NENI 24 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE LIGJI I APLIKUESHËM

24.1. Zgjidhje miqësore

Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese, që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë. Secila Palë njofton me shkrim Palën tjetër për ekzistencën e mosmarrëveshjes apo kundërshtisë dhe Palët mblidhen për të arritur një zgjidhje brenda 1 muaji nga njoftimi që ju është dhënë.

24.2. Eksperti teknik dhe ekonomik

24.2.1. Dështimi i zgjidhjes miqësore

- a) Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët brenda 1 muaji sipas neneve të përmendura më lart, Palët do të drejtohen një ekspert (“Ekspert Teknik dhe Ekonomik”) i cili brenda 1 muaji propozon një zgjidhje.
- b) Kur përcaktimi i një zgjidhjeje nga një ekspert teknik/ ekonomik është i nevojshëm, asnjëra palë nuk mund ti drejtohet një arbitri ndërkombëtar, përpara se të ketë mbaruar afati i përcaktuar 1 mujori i dhënë për ekspertin teknik/ekonomik

24.2.2. Zgjedhja e ekspertit teknik dhe ekonomik

- a) Procedura për emërtimin e një eksperti teknik dhe ekonomik do të jetë si më poshtë :
- (i) Pala që dëshiron ti drejtohet një eksperti teknik ekonomik njofton palën tjetër për këtë qëllim, në këtë njoftim jep detajet dhe arsyet pse ju referuan ekspertit teknik dhe ekonomik.
 - (ii) Palët takohen për të rënë dakort mbi një person që të jetë ekspert teknik dhe ekonomik.
 - (iii) Personi i përcaktuar ekspert teknik dhe ekonomik sipas dispozitave lartpërmendura do të njoftohet nga palët për zgjedhjen e bërë nga (NJZP). Duke kërkuar një konfirmim brenda 14 ditëve nëse eksperti është apo jo i/e gatshëm dhe në gjendje të pranoi emërimin.
 - (iv) Nëse personi i përcaktuar nuk është i gatshëm/në gjendje apo nuk konfirmon në periudhën e përcaktuar brenda 14 ditëve gatishmërinë/aftësinë dhe nëse palët nuk janë në gjendje të bien dakort për një person tjetër, çështja do ti drejtohet NJZP për të zgjedhur apo rizgjedhur një ekspert teknik dhe ekonomik. Procesi do të vazhdojë derisa një person i cili pranon caktimin si ekspert teknik dhe ekonomik të gjendet, dhe
- b) Një person nuk mund të emërohet si ekspert teknik dhe ekonomik:
- (i) Nëse personi i tillë nuk është i kualifikuar me arsimimin, përvojën dhe trajnimin e përshtatshëm për të përcaktuar çështjen e mosmarrëveshjes;
 - (ii) Nëse personi i tillë ka një interes ose detyrë që do të përbënte një konflikt interesi, me rolin e tij/saj (përfshirë një drejtor, zyrtar ose punonjës konsulent për një palë ose për çdo bashkëpunëtor të një Pale), apo
 - (iii) Nëse personi i tillë është shtetas i juridiksionit të secilës Palë të kësaj Kontrate ose të juridiksionit të çdo konçesionari ose grupi të aksionarëve, dhe as nuk duhet të jetë punonjës apo agjent ose ish – punonjës ose agjent i këtij personi.

24.2.3. Fuqi ligjore e vendimeve të Ekspertëve Teknik dhe Ekonomik

- a) Procedurat e mëposhtme do të zbatohen kur është i kërkuar caktimi i një eksperti teknik dhe ekonomik :
- (i) Secila Palë do të ofrojë informacione ekspertit teknik dhe ekonomik sipas kërkesave të ekspertit brenda 30 ditësh nga emërimi.
 - (ii) Eksperti Teknik dhe Ekonomik do të japë vendimin e tij/saj sa më shpejt që është e mundur pas marrjes së të dhënave, të informacionit, të dhëna nga palët, dhe në cdo rast jo më vonë se një (1) muaj pas ai/ajo u ka konfirmuar pranimin Palët të emërtimit të tij/saj.
 - (iii) Eksperti teknik dhe ekonomik nuk do marrë parasysh ndonjë informacion ofruar

- dhe dhënë pas periudhës 1 mujore të përmendur më sipër përveç rasteve kur ky informacion i ofrohet/jepet si rezultat i një kërkese specifike të ekspertit.
- (iv) Eksperti Teknik dhe Ekonomik ka të drejtë të marrë profesionistë të pavarur dhe/ose këshilla teknike, që ai mund ti konsiderojë të arsyeshme dhe të marrë çdo ndihmë sekretarie që të jetë e nevojshme, ne çdo rast duke përmbushur kriteret e parashikuara në shkronjën b)/iii të nenit 24.2.2.
 - (v) Eksperti Teknik dhe Ekonomik jep arsyet e plota me shkrim për vendimin e tij
- b) Vendimet e ekspertit teknik dhe ekonomik janë përfundimtare dhe detyruese për palët përveç:
- (i) Në rastin e një gabimi të dukshëm ose mashtrimi ose
 - (ii) Nëse brenda 1 periudhe mujore nga njoftimi i vendimit të ekspertit teknik dhe ekonomik njëra palë njofton me shkrim palën tjetër, duke deklaruar qëllimin e saj për t'iu drejtuar një arbitrazhi ndërkombëtar në lidhje me mosmarrëveshjen, me kusht që pala që po i drejtohet arbitrazhit ndërkombëtar të fillojë procedurën përkatëse brenda afatit sipas Nenit 23.3.3
- c) Të gjitha komunikimet ndërmjet Palëve dhe ekspertit teknik dhe ekonomik ose NJZP bëhen me shkrim dhe një kopje e saj i jepet në të njëjtën kohë Palës tjetër. Asnjë takim midis ekspertit teknik dhe ekonomik ose NJZP dhe Palëve, ose njëres prej palëve, nuk do të bëhet nëse palët nuk kanë një mundësi të arsyeshme për të marrë pjesë në takim.
- d) Eksperti teknik dhe ekonomik nuk do të konsiderohet si arbitër, por do të nxjerrë vendimin e tij si një ekspert.
- e) Çdo palë do të përballojë shpenzimet e veta për dhënien e informacionit dhe të dhënave, si dhe kostot dhe shpenzimet e konsulencës dhe punonjësve të mbajtur nga ETE por (nëse Ekspert Teknik dhe Ekonomik do të bëjë dhënien e këtyre kostove dhe shpenzimeve të cilat, nëse do të jetë pjesë e vendimit ekspert teknik dhe Ekonomik) kostoja dhe shpenzimet e ekspertit teknik dhe ekonomik dhe çdo këshilltari të pavarur për Ekspertin teknik dhe ekonomik, dhe të gjitha kostot e emërimit të tij/saj do të përballohen në mënyrë të barabartë nga Palët.

24.3. Arbitrazhi

24.3.1. Në rast se Palët nuk janë në gjendje për të zgjidhur një mosmarrëveshjeve me përdorimin e procedurave të përcaktuara më lart, atëherë, secila palë ka të drejtë të t'i drejtohet arbitrazhit ndërkombëtar për zgjidhjen e tyre siç parashtrohen më poshtë.

- (a) Kur një Palë dëshiron të drejtojë një çështje për arbitrazh ndërkombëtar në

pajtim me kushtet e kësaj Kontrate, njofton me shkrim palën tjetër, dhe mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga arbitrazhi ndërkombëtar sipas rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Selia e arbitrazhit është në Vjenë, Austri

(b) Gjuha e procedurës së arbitrazhit është anglishtja.

(c) Të gjithë dokumentet e dorëzuara lidhur me procedurat e arbitrazhit do të jenë në gjuhën angleze (duke përfshirë çdo njoftim siç parashikohet më poshtë), ose, nëse jo në gjuhën angleze, e shoqëruar me një përkthim të certifikuar anglisht.

24.3.2. Çdo vendim arbitrazhit i nxjerrë, ka formë të shkruar, ka arsyet mbi të cilat është bazuar, dhe është përfundimtar dhe detyrues për palët.

24.3.3. Gjykimi do të bëhet nga një grup prej 3 arbitrash ku secila palë do të zgjedhë një arbitër dhe dy arbitrat do të zgjedhin arbitrin e tretë. Gjuha e procedimit do të jetë anglisht.

24.4. Ligji i Aplikueshëm

Ligji i aplikueshëm për lidhjen, zbatimin, interpretimin e kësaj kontrate dhe për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve që lindin ndërmjet palëve për sa i përket zbatimit të kësaj kontrate, është ligji shqiptar.

NENI 25 - SANKSIONET

25.1. Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, në përfundim të periudhës të parashikuar në këtë kontratë penalizon Konçesionarin si më poshtë:

a) Për shkelje të afatit të përfundimit të ndërtimit

- (i) 56,000 Lekë/ditë vonese. Ky penalitet është kusht penal gjobor dhe fillon të aplikohet pas muajit të dytë të vonesës por jo më shumë se një muaj;
- (ii) 112,000 Lekë/ditë vonese. Ky penalitet është kusht penal gjobor dhe fillon të aplikohet pas muajit të tretë të vonesës por jo më shumë një muaj;
- (iii) 175,000 Lekë/ditë vonese. Ky penalitet është kusht penal gjobor dhe fillon të aplikohet pas muajit të katërt të vonesës por jo më shumë se një muaj;
- (iv) 315,000 Lekë/ditë vonese. Ky penalitet është kusht penal gjobor dhe fillon të aplikohet pas muajit të pestë të vonesës në vijim.

25.2. Për moskryerje në total të investimeve për vlerën e të cilës është rënë dakort, Konçesionari penalizohet me 2% të vlerës së investimeve të përealizuara. Ky penalitet është kusht penal gjobor.

25.3. Vonesa

a) Vonesa në përfundimet paraprake

Me përjashtim rasteve të parashtruara në Kontratë (rrethana të veçanta gjatë fazës së ndërtimit – shtyrja e përfundimit të fazave të ndërtimit), nëse përfundimi i një impianti nuk ndodh në datën e planifikuar, përveçse për shkaqet që nuk janë në kontrollin e Konçesionarit, ky i fundit do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues dëmet dhe kamatëvonesat ligjore.

b) Vonesa e veprimeve korigjuese.

Në qoftë se Konçesionari nuk ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme korigjuese për të përmirësuar shkaqet e mos përbushjes të vëna në dukje në njoftimin e Vërejtjeve, brenda një kohe të arsyeshme por jo me shume 60 ditë kalendarike, pas skadimit të këtij afati kohor, ai i paguan Autoriteti Kontraktues dëmet, në lidhje me impiantet, me këstet përkatëse për çdo ditë vonesë.

25.4. Mosrealizimi i prodhimit të Energjisë Elektrike dhe fuqisë së vendosur sipas kushteve të rëna dakort me këtë Kontratë, penalizon Konçesionarin si më poshtë:

- a) Në rast mosrealizimi, për faj të Konçesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike të përcaktuar tek Projekti i Zbatimit i miratuar nga Autoriteti Kontraktues, ndaj Konçesionarit aplikohet kushti penal gjoror në masën 2.2% të vlerës së prodhimit të përcaktuar për periudhën raportuese. Në rast se dështimi i prodhimit të energjisë elektrike ndodh për shkak të shkaqeve të ligjshme (jo për fajin Konçesionarit) konçesionari nuk do të penalizohet, për prodhimin e pa realizuar, pasi të ketë marrë miratimin e Autoritetit Kontraktues.
- b) Konçesionari, në asnjë rast nuk mund të instalojë me pak se 20% të fuqisë së instaluar të deklaruar në ofertë. Në rast se Konçesionari instalon më pak se 20% të fuqisë së instaluar të deklaruar në Ofertë, pa paraqitur më parë shkaqet teknike sikundër rregullohet në dispozitat e nenit 15 të kësaj Kontrate, atëherë Konçesionari penalizohet në shumën e llogaritur si më poshtë:

Shuma e penalitetit = *Prodhimi vjetor i energjisë elektrike x Fuqia e painstaluar (në %) x Vitet e operimit si të llogaritura në ofertë x Çmimi i shitjes së energjisë elektrike vendosur nga ERE në momentin e kryerjes së testimit të veprës sipas nenit 15 të kësaj kontrate x Fee Koncesionare (në%).*

Ky penalitet do të aplikohet vetëm një herë në momentin e testimit të veprës sipas kësaj Kontrate.

25.5. Palët bien dakort që sanksionet e parashikuara, si dhe çdo pretendim reciprok për fitimin e munguar apo çdo dëmshpërblim duke përfshirë edhe kushtin penal gjoror, deri në fillimin e fazës së Operimit, do të zbatohen deri në një vlerë prej 5% të vlerës së investimit (Sigurimi i Kontratës). Sanksionet do të llogariten, sipas një akti rakordimi të përbashkët që bëhet ndërmjet palëve të kësaj Kontrate.

25.6. Mosparaqitja në kohë e projektit të zbatimi për miratim tek Autoriteti Kontraktues, e penalizon Konçesionarin me kushtin penal gjoror në masën 0.002% të vlerës së investimit për çdo ditë vonesë.

- 25.7. Sanksionet paguhen në llogari të Autoritetit Kontraktues. Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari do të diskutojnë për një periudhë 1 mujore lidhur me shkeljen.
- 25.8. Kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 3 muajsh. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.
- 25.9. Aplikimi dhe pagimi i penalteteve sipas këtij neni nuk e çliron konçesionarin nga përmbushja e detyrimeve dhe parashikimeve të kësaj kontrate.

NENI 26 - RREGULLIMI I SHKELJEVE

- 26.1. Kur Autoriteti Kontraktues, konstaton se gjatë Periudhës së Konçesionit, Konçesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë Kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Konçesionarit duke pritur për një periudhë 3 muaj përgjigjen e tij, me argumentet përkatëse. Palët me kontratë të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.

NENI 27 - TRANSFERIMI I ASETETEVE DHE PERIUDHA KALIMTARE

- 27.1. Në 6 (gjashtë) muajt e fundit të periudhës së konçesionit, Konçesionari do të fillojë procedurat e transferimit të objektit të koncesionit sipas detyrimeve të përcaktuara në pikën 27.2 dhe do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktues (ose ndonjë palë e tretë të caktuar nga Autoriteti Kontraktues), për të dorëzuar impiantet.
- 27.2. Menjëherë pas mbarimit të Periudhës së Konçesionit :
 - (a) Çdo impiant duhet të jetë (i) në një gjendje të mirë, në përputhje me çdo regjim për mirëmbajtjen e planifikuar, dhe (ii) i aftë të plotësojë kushtet minimale teknike, që i nënshtrohet një zhvlerësimit të arsyeshme;
 - (b) Të drejtat e konçesionit automatikisht shuhet dhe Konçesionari nuk ka të drejtë të përdorimin dhe posedimin e impianteve përkatëse, kantierët si dhe të drejtën e kalimit;
 - (c) Konçesionari, me qëllim plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë kontratë, (nëse janë të zbatueshme), menjëherë i transferon tek Autoriteti Kontraktues, pa pagesë dhe pa barrë apo peng, në gjendjen “siç është”, të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat e tij që kanë lidhje me impiantet, (për aq sa ato janë pjesë e ose të përdoren në Projekt), si më poshtë:
 - (i) të gjitha lëndëve të para, konsumit dhe pjesë këmbimi,
 - (ii) të gjitha pasurive të prekshme personale në funksion të objektit të kontratës,

- (iii) të gjitha pasurive të paprekshme personale ne funksion te objektit te kontratës, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale (që nuk janë transferuar me liçencë),
- (iv) të gjitha ndërtesat dhe mjetet,
- (v) të dhënat e kompjuterizuara dhe jo-kompjuterizuar, raporte, të dhëna, fotografi, dhe informacion, skica, rezultatet e testit, dokumentet,
- (vi) të gjitha garancitë e materialeve, pajisjeve dhe punimeve
- (vii) të gjitha të drejtat e kontratës duke përfshirë qiratë dhe policat e sigurimit,
- (viii) të gjitha veprat në progres (duke përfshirë punimet e ndërtimit, nëse e zbatueshme) sipas kontratave me shitësit, furnizuesit, kontraktorët dhe nënkontraktorët, dhe
- (ix) të gjitha të drejtat në lidhje me çfarëdo sigurimi të ardhurave qe duhen paguar ose për llogari Konçesionarit, por e papaguar në datën e përfundimit të kësaj Kontrate, në lidhje me titullin e Konçesionarit, të drejta dhe interes në projekt.

NENI 28 - MBARIMI I KONTRATES

- 28.1. Kjo Kontratë mbaron me përfundimin e afatit 35 vjeçar, duke patur parasysh parashikimet e nenit 4 të kësaj kontrate.
- 28.2. Mbarimi i kontratës si përfundim i Periudhës së Konçesionit ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e çliron Konçesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

NENI 29 - KONFIDENCIALITETI

- 29.1. Secila nga Palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe informacionet e tjera në lidhje me Projektin, qofshin këto tregtare apo teknike , dhe nuk duhet t'ja beje të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e Palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj Kontrate.
- 29.2. Pavarësisht nga dispozitat e tjera, informacioni mund të jepet pa pëlqimin e palës tjetër
 - (a) Organeve shtetërore;
 - (b) nga konçesionari për Palët fituese;

- (c) nga një Palë për drejtorët e saj, zyrtarët, punonjësit, agjentët dhe këshilltarët teknikë dhe profesionalë dhe çdo bashkëpunëtor i kësaj pale që në mënyrë të arsyeshme kërkon informacion të tillë gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisive të tij në lidhje me këtë Kontratë;
 - (d) nga një Palë për kontraktorët e tij dhe furnizuesit deri në masën e arsyeshme për përmbushjen e detyrimeve të tyre;
 - (e) nga një Palë, në masën e kërkuar, për qëllime të marrjes dhe ruajtjes e sigurimeve;
 - (f) në masën e kërkuar nga ligji, autorizimet ose rregullat e ndonjë burse të njohur në të cilën aksionet e palës së në fjalë, janë të kuotuar;
 - (g) për qëllime të zgjidhjes së konflikteve ose zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve sipas kësaj Kontrate, dhe
 - (h) për aq sa një informacion të tillë publik;
- 29.3. Çdo informacion, i marrë në përputhje me këtë nën, përdoret për qëllimet e kësaj kontrate

NENI 30 - NDRYSHIME

- 30.1. Kjo kontratë mund të pësojë ndryshime, shtesa dhe /ose zëvendësimeve me kontratë me shkrim të dy palëve.
- 30.2. Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyj në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse e pandashme e kësaj kontrate.

NENI 31 - TE NDRYSHME

31.1. Caktimi - Siguria

- a) Konçesionari nuk do të shesë, ose të transferojë të drejtat e tij ose detyrimet që lindin nga kjo Kontratë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues, sipas përcaktimit në ligjin 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”. Gjithsesi, konçesionari ka të drejtë, në masën e lejuar nga ligjin dhe siç mund të kërkohet në Dokumentet e Financimit, të vendosë hipotekë ose të transferojë të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate (duke përfshirë edhe Impiantet) dhe interesat e tij në Projekt me qëllim të ofrimit të garancisë për Palët Financuese.
- b) Çdo veprim për shitje, apo shitje të supozuar, shitje me barrë, caktimi apo transferimi e të drejtave apo detyrimeve ose interesave, nga konçesionari tek të tretët, jo në përputhje me kushtet e këtij neni duhet, është nul, i pavlefshëm dhe pa efekt.

- c) Përgjegjësia solidare e Konçesionarit dhe përfundon në Datën e Përfundimi të Punimeve dhe do të zëvendësohet me një garanci në shumës e 1% Aktuale të Investimeve gjatë kohëzgjatjes të Fazës së Operimit.

31.2. Gjuha

Pa cënuar procedurën e Arbitrazhit, më sipër, kjo Kontratë do të nënshkruhet dhe zbatohet në gjuhën Shqipe dhe ne gjuhën Angleze. Në rast mospërputhjes ose konfliktesh, mbizotëron versioni i gjuhës Shqipe mbi gjuhën Angleze. Të gjitha komunikimet dhe njoftimet ndërmjet Palëve do të jenë në gjuhën Shqipe.

31.3. Fosilet dhe Antike

- a) Pa paragjykuar të drejtat e Konçesionarit për çdo shtyrje të përfundimit të fazave të ndërtimit, Konçesionari duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues dhe të ndërpresë Punimet në Sheshe, nëse zbulohen fosile apo antikave (në Sheshin apo rrethinat e tij),
- b) Pas pranimit të njoftimit të Konçesionarit, Autoriteti Kontraktues do të informojë autoritetet kompetente shqiptare dhe të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar që ata në mënyrë të shpejtë e të koordinuar të hulumtojnë fosilet ose antikave në lidhje me këtë Shesh.
- c) Në rast se raporti i autoriteteve kompetente shqiptare tregon mundësinë e heqjes së antikave ose fosilet nga Sheshi, Konçesionari duhet të paguajë të gjitha shpenzimet e heqjes së fosileve ose antikave.
- d) Në rast se raporti me shkrim të autoriteteve kompetente shqiptare tregon se ndërtimi nuk mund të vazhdojë në Sheshin në të cilën fosilet apo antikave u zbuluan, Autoriteti Kontraktues mund të vendosë ti japë Konçesionarit një Shesh tjetër me karakteristika të ngjashme.
- e) Autoriteti Kontraktues duhet të paguajë shpenzimet e transferimit të Punëve për zëvendësimin e Sheshit, me kusht, që konçesionari të sigurojë gjithë ndihmën e arsyeshme për të ndihmuar Autoritetit Kontraktues të minimizojë kostot përkatëse dhe vonesat.

31.4. Vlefshmëria e kësaj Kontrate

Nëse ndonjë term apo dispozitë e kësaj Kontrate rezulton e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek dispozitat e tjera. Në këtë rast dispozita e pavlefshme zëvendësohet nga dispozita përkatëse

e ligjit ose nga një dispozitë tjetër, nëse Palët bien dakord. I njëjti kriter vlen edhe në rastin kur ka ndonjë të mungesë të paqëllimshme në tekstin e kësaj kontrate.

31.5. Marrëveshja e Plotë

Kjo Kontratë, duke përfshirë edhe hyrjen dhe Anekset bashkangjitur, vullnetin e Palëve në lidhje me Projektin dhe zëvendëson çdo kontratë të mëparshme ose të gjitha rregullimet, me gojë ose me shkrim, midis palëve në lidhje me Projektin.

31.6. Pamundësia e Heqjes dorë nga Marrëveshja

31.6.1. Asnjë dispozitë e kësaj Kontrate nuk bën të mundur tërheqjen e palëve nga kontrata përveç se kur tërheqja njoftohet me shkrim. Dështimi, i secilës palë, për të përmbushur detyrimet e kësaj kontrate nuk do të interpretohet asnjëherë si tërheqje nga marrëveshja apo heqje dorë nga të drejtat apo detyrimet që rrjedhin nga ajo.

31.7. Hyrja në fuqi e Kontratës së Konçesionit

Kontrata e Konçesionit hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët, në përputhje me Ligjin 125/2013 “Për Konçensionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar.

31.8. Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit

- a) Pa cënuar nenin për Arbitrazhin më sipër, çdo njoftim ose komunikim tjetër ndërmjet Palëve do të jetë : (i) i bërë në gjuhën angleze dhe/ose në gjuhën shqipe (ii) me shkrim, (iii) i dorëzuar personalisht (dorazi) ose të dërguara me postë rekomande të parapaguar në adresën e palës tjetër të përfshirë në këtë kontratë ose në ndonjë adresë tjetër të njoftuar nga palët, ose të dërguar me fax (duke marrë konfirmimin e transmetimit) në numrin e faxit të Palës tjetër i cili është përfshirë më poshtë ose në ndonjë numër tjetër të njoftuar nga Palët, dhe (iv) duhet të jetë shënuar për vëmendjen e personit të caktuar më poshtë, ose të çdo personi që do të caktohet nga pala tjetër .
- b) Çdo njoftim ose komunikim tjetër i bërë nga një palë për palën tjetër, në përputhje me dispozitat e mësipërme të këtij neni do të konsiderohet të jetë marrë nga Pala tjetër, nëse është dorëzuar dorazi në ditën që ajo është lënë në Adresën e palës më poshtë (që mund të modifikohet nga koha në kohë pas njoftimit të arsyeshme nga secila Palë për Palën tjetër), nëse është dërguar nëpërmjet postës me parapagim, postë rekomande ose me korrier dyzet e tetë (48) orë nga data e postimit, ose nëse dërgohen me anë faksit, siç parashikohet më sipër. Adresat dhe numrat e kontaktit që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Kontrate janë:

Për Autoritetin Kontraktues

Për Konçesionarin

Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Blvd. Zogu i Pare, Nr. 1001,
Tiranë - Shqipëri

Shoqëria "Kovlu Energji" sh.p.k.
Adresa: Njësia bashkiake Nr. 5, Rruga
Sami Frashëri, pranë Qendrës Nobis,
Kulla F, Kati i 2-te, Tirane, Shqipëri

32.Regjistrimi i Kontratës

Brenda 1 muaji nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Uzufuktit, kjo Kontratë së bashku me dokumentacionin përkatës do të Regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme nga Konçesionari. Autoriteti Kontraktues do të zgjidhë çdo pengesë ligjore që mund të shfaqet për regjistrimin e marrëveshjes së Uzufuktit dhe Kontratës Koncesionare pranë ZVRPP përkatëse.

Kjo kontratë është hartuar në gjashtë (6) kopje, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, dhe pasi u lexua nga palët që e kuptuan dhe pranuan atë, u nënshkrua me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, dhe unë, noteri e dëshmoj atë rregullisht sipas ligji.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Përfaqësuar nga :

z. Ilir Bejtja






KONCESIONARI

Shoqëria "Kovlu Energji" sh.p.k.

Përfaqësuar nga :

z. Yüksel Çinar




Noter







Vertical text on the right side of the page, possibly a page number or reference code.

Small text or markings at the bottom left of the page.

